



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË SHTATË TË RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË VITISË

Mbledhja u ftua dhe u kryesua nga, z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë. Ajo u mbajt më 29.07.2025 (e martë), në shtëpinë e kulturës "Gursel e Bajram Sylejmani", duke filluar punimet në ora 10:00. Në mbledhje morën pjesë: kryesuesi i Kuvendit, z.Bekim Azizi; nënkryetari i Komunës, z.Hasan Aliu; këshilltarët e Kuvendit: z.Ali Bajrami, z.Sokol Shaqiri, z.Sokol Hyseni, z.Ramadan Deliu, znj.Valentina Mehmeti, zn.Zejnepe Osmani, z.Illir Zuka, z.Ekrem Ymeri, zn.Arbnora Hajredini, z.Basri Sylejmani, z.Jakup Demiri, zn.Liridona Bislimi, z.Sejdi Emini, z.Nexhat Halili, znj.Majlinda Shabani, z.Durim Sylejmani, zn.Lindita Demelezi, zn.Vilsona Maliqi-Saliu, z.Reshat Azizi, z.Taulant Haxhiu, z.Musli Neziri, z.Veton Ramadani, zn.Anisë Zejnullahu. Pjesëmarrës të tjerë: drejtorët e drejtorive komunale, përfaqësues të Zyrës së Kryetarit, përfaqësues të mediave elektronike dhe të ftuar të tjerë. Munguan: z.Remzi Saliu, zn.Marigona Avdiu, zn.Zyrafete Rama. Pasi u konstatua prania e 24 anëtarëve të Kuvendit Komunal, kryesuesi e shpalli të hapur mbledhjen, duke theksuar se pritet që edhe anëtarë të tjerë të bashkohen gjatë zhvillimit të saj.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Mirëdita dhe mirë se keni ardhur në seancën e shtatë të rregullt të Kuvendit Komunal të Vitisë! Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Materialin e keni marrë me kohë, para se të fillojmë me punime të seancës, duke pas parasysh që para 2 dite ka ndrruar jetë një ish kryetar i komunës, i cili me 2 mandate ka udhëheq Komunën e Vitisë, kërkoj nga të gjithë të pranishmit ta nderojmë me 1 minut heshtje. Lavdi! Gjatë kësaj periudhe nuk na ka ardhë asnjë konfirmim i ligjshmërisë për mbledhjet e kalaura që janë mbajtur. Tani është koha e pushimeve të mërgimtarëve. Në emër të kuvendit i uroj të gjithëve mirëseardhje. Para se të hymë në rend të ditës, hapi diskutimin për pyetje dhe përgjigje. Fjala është për juve.

z.Basri Sylejmani: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Pyetja është për te varrezat në Lubishtë, familjes Bilalli, që të shtrohet një pjesë me asfalt. Dhe tjetra, stacioni ku ndalen autobusët në Gërmovë është dëmtu shumë dhe ka dëmtu kanalizimin e shtëpisë, që është afër rrugës kryesore. Është mirë të merren masa menjëherë.

z.Illir Zuka: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Në mbledhjen e KPF-së kam kërku prej nënkryetarit dhe drejtorit të shërbimeve publike, me dërgu një shkresë në ministrinë përkatëse, që është për mirëmbajtjen e rrugëve regjionale. Dje e kemi parë dhe në plus televizion, përveq në Pozheran që është ruga e qendrës jashtëzakonisht e dëmtume, pjesë pjesë e pakaluar. Gjendjen e njëjtë e kemi edhe në Ramjan, një pjesë e Budrikës dhe një pjesë e Novosellës. A duhet me ndërmarr dikush diçka? Unë kam kërku prej nënkryetarit që, me dërgu një shkresë, me na leju komuna vetë me rregullu atë pjesë, se është bërë e pakalueshme.

z.Jakup Demiri: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Nënkyetar, deshta të dijë te puna e shpronësimit të parcelës në Letnicë: a ka probleme aty me banor, dhe a është i involvum ambasadori i Kroacisë, për me pengu atë shpronësim apo atë punë? E dimë që 2-3 vite ajo është zhagrit, pak qëllimisht pak me disa aryse, por tani po na del dhe kjo. Unë kam informata prej banorëve aty që, ajo nuk bëhet, ka me u pengu. A keni ndërmarr diçka? Ndërsa pyetja tjetër është rreth trotuareve nëpër lokalitete të Komunës së Vitisë. D.m.th për të gjitha trotualet që nuk janë të kryme, tu fillu prej Smirës, Trestenikut, Kabashi dhe trotuari në fshatin tu dalë prej Vitisë që shkon ka shkolla. Ai nuk i ka 2 vite që është shtrur dhe është shumë i dëmtum. Është mirë me dalë me i kqyrë. Dhe kam një pyetje konkrete: a kryhet këtë vit apo nuk kryhen këto? Ndërsa pyetja tjetër ka të bëjë me zjarrfikësit, se në këtë kohë kanë pas shumë angazhim të madh me zjarret, dhe a ka nda komuna një mbështetje financiare për ta apo si kanë funksionu zjarrfikësit?

znj.Liridona Bislimi: Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Kam një pyetje që ka të bëjë me një rrugë të fshatit Drobesh, për shkak se komisioni për emërtimin e rrugëve dhe rrugicave që 8 vite nuk ka qenë asnjëherë funksional. Kjo rrugë nuk është e emërtuar, po flas për rrugën që është përbërë xhamisë së fshatit Drobesh. Kjo rrugë ka fillu me u shtrë gjatë mandit të kaluar, është shtruar një pjesë e shkurtë, as gjysmë kilometre dhe ka mbetur. Ka pas premtim të vazhdueshme dhe fushata të vazhdueshme që është përdor shtrimi i kësaj rruge, qoftë për nivelin lokal, nacional nga ish drejtori i atëhershëm i fshatit Drobesh, por asnjëherë nuk është shtrë. Tash, sidomos me ardhjen e mërgatës, kërkojnë me ditë kjo rrugë kur ka me u shtrë, se është e rëndësishme, se kjo rrugë bënë lidhjen e fshatit me pjesën e fundit të Drobeshit të Poshtëm. Për çështjen tjetër kemi bisedu edhe me drejtorin e shërbimeve publike përmes telefonit, dhe shumë qytetar. Ky trapi i famshëm që është bërë temë diskutimi në Komunën e Vitisë, që kemi parë në plus televizion dhe në ueb faqe të ndryshme në fshatin Beguncë. Unë kam bisedu me drejtorin dhe kam kërku sqarim, dhe kam kërku që me u largu për shkak që është jo e hijshme, e logjikshme me u vendos një trapë në kthesë dhe në perpjetze. Normalisht punimet komunale duhet me u bërë me ju shërby, me ja u lehtësu qytetarëve jetën, e ky trap është e kundërta e kësaj, sidomos në kohën e vjeshtës dhe dimrit. Se çka kanë me vepru ata banorë të fshatit Beguncë, kemi parë dhe një mori të ankesave të qytetarëve, dhe unë në emër të tyre po flas që, duhet me u largu urgjentisht. Dhe çështja tjetër ka të bëjë me rrugën "Skender Salihu", është rruga para se me mrri tek restaurant "Roza", ish restaurant "Lindi" në Viti. Me ramjen e një rige shiu që ka ndodh sot, sitata e kësaj rruge është kështu. Ne po flasim për një rrugë që është në qytet të Vitisë, e cila kjo rrugë përfshin më shumë se 20 shtëpi. Ajo çka është më interesante gjatë takimit që kam pas me këta banorë, çka më kanë tregu ka qenë se, prej vitit 2018 vazhdimisht kanë takime dhe biseda me institucionet komunale, tu fillu prej të parit të Vitisë. 2 herë kjo rrugë paska qenë brenda buxhetit konual për implementim dhe 2 herë është terhek. Sipas banorëve, edhe para 2 viteve ka pas emra konkret të drejtorëve aktual, të cilët kanë premtu që kjo rrugë ka me u shtrë dhe ende situata është e tillë, përderisa Komuna e Vitisë ka buxhet për shtrimin e rrugëve, arave, rrugicave nëpër disa fshatara që nuk kanë asnjë shtëpi të vetme: si është e mundur nënkryetar mos me pas buxhet komunal për me shtrë kaq afër dhe e përfshin një numër të konsiderueshëm të shtëpive? Pse me ndodh këto rrethana që i përmenda, pse me hy 2 here në implementim të buxhetit, dhe me u largu, pse me pritë kaq gjatë për me u shtrë, dhe kur ka me ndodh shtrimi i kësaj rruge.

z.Sokol Shaqiri: Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Kam një shqetësim rreth banorëve të fshatit Tërpezë. Shqetësimi jonë është, prej vitit 2017 janë në qarkullim disa biseda, dhe në vitin 2017 një kompani e cila quhet "Zhuti", kompani prej Lipjanit, d.m.th në vitin 2017 kjo iniciativë është ndalu prej banorëve të fshatit Tërpezë. Tash kanë fillu disa zëra dhe takime që janë duke u mbajtur msheftas, bile është caktu një takim në Pozheran në muajin e ardhshëm, me 27.08. Arsyeja pse është caktu në Pozheran, pse nuk është caktu në fshatin Tërpezë, pasi që edhe ne kemi një shkollë, kemi një konak që ti presim. Dua ta di prej komunës: a janë në dijeni për këtë iniciativë? Sepse 90% e fshatit Tërpezë e marrim ujësjellësit prej vendit të quajtur "Sintulla". Dua ta njoftoj komunën, e të gjithë që të merren masa ndaj kësaj iniciative që parashef gurëthyes. Ne nuk jemi kundër investimeve, por primare është uji.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Ja drejtojmë edhe një kërkesë drejtorit të mjedisit, planifikimit dhe urbanizimit. Sot nuk është këtu, ai e din a ka ndonjë kërkesë, se pa pas ndonjë kërkesë, nuk mund me pas iniciativë prej ktuhit në bazë të dokumenteve. Zkonisht gurëthyesit kanë koordinim prej komunës dhe ministrisë.

z.Sokol Shaqiri: Unë e kam një raport këtu prej 25 faqeve, që thotë që, nuk rrezikon asgjë, por kjo nuk është e vërtet. Prej fshatit janë 3 kilometra, por prej parkut te pishat hapsira është 1 km. Ne pretendojmë që ujësjellësin ta merremetojmë vitet e ardhshme, kështu që të marrim masa.

znj.Majlinda Shabani: Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Po e shof që, seanca ka fillu me u mbajt normale, e dimë që në praktikat e kalume në fund të korrikut kur i kemi mbajtur seancat e kuvendit komunal, na ka ardhë raporti i punës së kryetarit, ku ne jemi ndërlidh në tema të ndryshme që i kanë prek qytetarët e Komunës së Vitisë. Sot Sokol Haliti e ka shkel ligjin, tu mos pru raportin e punës apo informatën në seancën e kuvendit komunal, dhe ne në këtë rast ekzekutivi po sillet shumë normal, tu ardh tu e mbajt seancën. D.m.th tu e pa këtë qasje jo serioze dhe veprim skandaloz, dhe në fund fyes ndaj qytetarëve të Komunes së Vitisë, që raporti i punës

neve nuk na ka ardh me diskutu në këtë seancë të kuvendit komunal. Nuk mundem me kuptu logjikën se qysh mundet me funksionu Sokoli, ku për 10 vite sa ka qeverisë i ka thurë lavde të vazhdueshme vetes, nuk e ka pas asnjë kritik të vetme. Për mua kjo tregon shumë që, Sokoli e ka një uri të pashtershme për pushtet dhe për fitim personal. Sot është dashtë me u diskutu raporti i punës, njëra prej dokumenteve më të rëndësishme që i intereson qytetarëve të Komunës së Vitisë, dhe e ka shkel ligjin Sokoli, e ka shkel ligjin sot.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Mund të diskutojmë që nuk e ka me vend, se kur të hymë në rend të ditës duhet me kërku këtë. Jashtë rendit të ditës jemi, pyetje përgjigje. Krejt këtë mund me diskutu në rend të ditës kur të hymë. Scanca është e kuvendit komunal, nuk është e ekzekutivit. Ekzekutivi i prezanton pikat te unë, unë me komitetin i miratojmë dhe i qojmë në kuvend komunal. D.m.th informatën nuk e kanë prurë për këtë seancë. Besoj në seancën tjetër e binë. Procedura e kuvendit është normale.

znj.Majlinda Shabani: Vitin e kaluar këto çështje që i kemi ngritë jashtë rendit të ditës, a i ke ndërlidh me raportin e punës dhe informatën ku nuk jemi kyç në pikat e ndryshme të rendit të ditës, por jemi pyet te informata, ku janë ndërlidh me çështje të ndryshme.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Qe dy mandate gati çdo herë e kemi ndërlidh pikën jashtë rendit të ditës, nuk e kemi mbajtur, i kemi bërë me një pikë për shakë që pika e informatës së kryetarit i përfshin krejt. Kësaj here nuk ka rradhë informata, sot bënë pyetje përgjigje. Kur të hymë në rend të ditës kërkoj këto çka je ti kërku.

znj.Majlinda Shabani: Nëse isha pyet unë komplet, edhe përkundër faktit që pasqyrat financiare menjëherë pas raportit të punës është dokumenti më i rëndësishëm që vjen. Për mua informata e kryetarit për këtë 6-mujor është raporti më i rëndësishëm që ne është dashtë me diskutu këtë muaj. Për çdo seancë unë kam diskutu për mos prezencën e Sokol Halitit në seancën e kuvendit komunal. Për mua është qasje fyese edhe ndaj qytetarëve dhe ndaj neve, kur ne pyetet tona i adresojmë ndaj ekzekutivit, dhe në asnjë seancë të kuvendit komunal, Sokol Halitin nuk e kemi prezent, se ai është tu tregu që e ka frikën me ardh me u ballafaqu.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Me të përballu ku ta takojsh, kur ti kish mediat e ke pas debatin publik kur e ka mbajtur e kur të vjenë këtu, por nuk ka pikë, se nuk e ka prurë. Kur ta bjen e diskutojmë. Kjo është pjesa jeme si kuvend që më takon. Kur të hymë në rend të ditës, kërko informatë pse nuk e kanë prurë tani jemi te pyetet përgjigjet.

znj.Majlinda Shabani: Je tu ndërlidh në veprime procedurale, për mua nuk është kjo e rëndësishme, për mua është e rëndësishme se si po funksionon kuvendi komunal, si po funksionon komuna dhe si po vijmë ne në kuvend komunal, thjesht me largu obligimin ndaj vetes me ardh me mbajtur seancë një herë në muaj dhe mos me u diskutu fare, pjesa që Sokol Haliti e ka shkel ligjin që nuk e ka sjellë raportin e punës.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Këshilltar, mirë, unë po themë e ka shkel ligjin, bëjë një procedurë, qoje në gjykatë e dënon gjykata. Unë po themë që në kuvend nuk e ka sjellë informatën, marrim poena negativ kur të vlerësohet performanca e kuvendit që nuk na ka ardhë rendi të ditës, d.m.th informata e kryetarit, informata për raportin financiar nuk është dokument, është informatë, nuk e bjen, marrim pikë negative.

znj.Majlinda Shabani: Do të ishte mirë me qenë sot prezent, besoj që pajtohet gjithsecili prej juve që mos me qenë fare në seancë, tregon një farë lloj joserioziteti që e ka edhe karshi qytetarëve dhe neve. Ne e kuptojmë dhe e dimë logjikën si funksionon ai. E para, për mua është që çdo kritikë që e kemi ndaj ekzekutivit me u gjetë zgjidhja. U diskutu pjesa e trapit që u vendos. Me sa e di që banorët e fshatit Beguncë janë tu e ndërmarr një hap si peticion për me largu atë. Kërkesa e kujt ka qenë që me u vendos në atë përpjetze dhe a kemi ndonjë ekspert të fushës që e bëjnë vlerësimin për me u vendos këto shenja të sigurisë së komunikacionit që e kanë parapa për këtë rast. Punimet që janë tu zhvillu në Komunë të Vitisë, qoftë në qendër të qytetit apo në trotuare të ndryshme, është një çështje që punimet në momentin që përfundojnë në këtë rast, p.sh.: kubzat nuk kthehen në vendin që kanë qenë më herët. Në qendër të qytetit afër xhamisë janë zhvillu disa punime afër trotuarti ku mandej ato kubzat nuk janë vendos në vendin e duhur dhe është një pengesë e madhe. Drejtori qenka prezent, kisha dashtë qysh sot me u trajtu kjo çështje dhe me u zgjidhë. Ka qenë dhe një problem tjetër në rrugën në dalje të Vitisë, në Ramnisht, pjesa e asfaltit që bëhet, në moment që bjen një reshje shiu bllokohet ajo rrugë. Për çdo vit është i njëjti problem. Po besoj që edhe aty duhet me u bërë një zgjidhje, dhe sot unë e pash që sot rruga është e pakalueshme,

për shkak të bllokimit të kanaleve. Dhe pjesa rreth lumit "Morava", përpos kritikës që kemi pas të vazhdueshme, në mënyrën se si është investu në atë rrugë, që ka qenë e shtruar me kubza, nuk ka qenë fare investim që është dashtë me u bërë në atë mënyrë. Punimet që janë bërë tash aty, janë tu e pa që janë tu zhvillu disa ndërtime. Dikush është tu bërë ndërtime dhe ato kubza janë largu. Aty gjithë kohën ka ujë, dhe nëse e merrë me kalu atë rrugë e ke shumë problem, dhe vetura veç prishet nëse kalon aty. Mua më interson me ditë se a duhet me u blloku ajo rrugë, me u bërë e pakalushme ose me u informu qytetarët që kjo rrugë nuk është në gjendje noramle për me kalu veturat, apo duhet të sillemi normal që ajo rrugë është krejt noramle, dhe ne me vazhdu me kalu ashtu.

z.Jakup Demiri: Te puna e pyetjeve dhe përgjigjeve. Në këtë pjesën e parë nuk është e percaktume a ke të drejtë më fol për filan temën apo nuk ke të drejtë, se kur është raporti i kryetarit, krejt kjo hapësirë kohore zgjerohet në raportin e kryetarit. Kryetari e ka 4 herë në vjet, d.m.th çdo 3 muaj me qenë në kuvend komunal, e ka obligim ligjor me pru raportin çdo 3-mujor në kuvend komunal dhe me diskutu. Në KPF kam kërku që me ardh 7 ditë përpara, që me analizu, me pas për çka me diskutu, se ke projekte që kanë bërë ka 4-5 vite pa u krye hiç, e ke borxhe të komunës, ke dallavere e gjithçka janë më të rënda se sa fol një asamblist, me plotë të drejtë e ka se nuk është e percaktume a ke të drejtë me fol për atë pikë a nuk k. Ne u takum, diskum dhe e lamë me diskutu tek ajo pikë, por ajo e ka mendimin e vet që ndoshta duhet me diskutu, nuk e percakton asnjë rregullore se kur ke me fol për atë pikë apo për atë pikë. Nuk ka ardh raporti, ka të drejtë me diskutu, asamblista nuk ka nevojë askush me reagu. Ne duhet me ditë atë. Të ju kujtoj dhe diçka që, raporti i fundit që ka qenë para 3 muajve i kryetarit, pasqyrat financiare, edhe raportet e drejtorive, asnjë me njëri tjetrin nuk kanë korrespondu. Unë e di që kjo është telashe, se ne edhe qato duhet me i këqyrë, pasqyrat financiare, raportin e kryetarit, raporti i drejtorave nuk perputhen mes vete. Këto gjëra duhet me i diskutu dhe nuk ka nevojë me reagu askush te tjetri, është kryesuesi këtu, ai menaxhon.

z.Nexhat Halili: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Pyetja ime e parë ka të bëjë me ndërtimin e troturave dhe ndriçimin publik. Me datën 27.10.2021 është lidhur kontratë në vlerë prej 820 mijë e 153.13 euro. Afati i kontratës ka qenë 2-vjeçar, prej 27.10.2021 deri me 25.10.2023. Në kuadër të kësaj kontrate përfshihen shumë trotuare dhe ndriçime publike, por unë po orientohej tek trotuari i fshatit Trestnik, i cili lidh Sllatinën me Trestenikun, të cilën çështje e kam ngritë shumë herë, mirëpo u bënë 4 vite dhe nuk shihet që do të përfundon ky trotuar. Po ju tregoj 2 fotografi, se si është gjendja e këtij trotuari. Kam edhe shumë foto tjera. Kur do të përfundoj ky trotuar? Dhe asfaltimi i rrugëve rurale në Komunën e Vitisë, kontrata është lidh me 25.11.2024, kontrata 3 vjeçare deri me 24.11.2027. Vlera e kontratës është 2 milion e 352 579.81 euro. Në kuadër të kësaj kontrate përfshihen shumë rrugë në territorin e Komunës së Vitisë. Po potencoj, 8 rrugë të cilat përfshihen në fshatin Trestenik, në të cilën në secilin takim kryetari i komunës ju ka premtu kësaj lagje se do të rregullohen këto rrugë. Këto rrugë kapin një gjatësi prej 713.77 metra, vlera e përgjithshme e këtyre rrugëve është 61 mijë e 115.94 euro, mirëpo nuk shof kurrfarë iniciative në këtë drejtim. Në kuadër të kësaj pyetje kam dhe për një rrugë të një familje të cilët e kanë një person të hendikepuar. Këtë çështje e kam ngritë edhe para 2 viteve, dhe para 3 seancave nuk është rrugë e gjatë, është rrugë e cila është shpronësuar dhe është më së shumti 200 metra. Edhe prindi i tyre ka qenë shpesh e ka paraqit këtë çështje, por për hatër të këtij invalidi të merrni ndonjë hap në këtë drejtim. Dhe tek uji i pijes, buxheti është ndarë për këtë vit diku 40 mijë euro për vitin 2026, 20 mijë euro. Në strukturat komunale kam pas kontakte dhe me "Hidromoravën", për ujësjellësin e 5 fshatrava ka lagje "Simixhiu", lagjja "Grem" aty afër janë, nuk i kan as 20 metra te bazenti ku është akomulu uji, por ata nuk kanë ujë të pijes. Në muajin e 3-të të këtij viti janë paraparë që të udhëheqen procedurat e prokurimit, mirëpo deri tani nuk shofë kurrfarë hapi në këtë drejtim. Kur do të fillojnë procedurat e prokurimit dhe pse ujë të pijes nuk ka, po ujë për amvisri?

z.Sejdi Emini: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Më herët është bërë një kërkesë dhe kemi diskutu në kuvend që me u rregullu organizimi i brenshëm i sistemit të vendeve të punës në Komunë të Vitisë. Nuk e di sa keni lëvizë në këtë drejtim, ka me dhjetra punëtorë brenda Komunës së Vitisë që nuk ju paguhet djersa, të cilat e bajnë edhe për të njëjtin vend të punës, paguhen ndryshe, d.m.th pothuajse të gjitha komunat e Kosovës e kanë rregullu, veç ne po bajmë padrejtësi ndaj tyre. Në Gjilan me 3 korrik është rregullu. Se pse po vonohet nuk e di,

por është dashtë me pru në kuvend dhe me rregullu, se ata janë njerëz hallegji që mbajnë familje me atë vend të punës, dhe kanë të drejtë. Ne me qenë për veten tonë jemi sigurt që secili kish bë me shumë për me i rregullu interesat personale, mirëpo kur është në pyetje për njerëzit, një shtresë që mbajnë familje po heshtin. Kjo nuk është e drejt. Unë këtu sa kesh, ma rikujtoj që ta ngris në seancë. Besoj që duhet urgjentisht me kry këtë punë. Basriu e përmendi në Gërmovë një parking të busit, ai parking është në Gërmovë, por tek rruga e Goshicës, që presin banorët e Goshicës. E kemi përmend edhe 2-3 herë, kam kërku me rregullu, se është gjendja e keqe. Pos asaj, pengesa, në hyrje të rrugës është një shtyllë elektrike për shoferët që e frekuentojnë atë rrugë. Drejtoresha e arsimit, po ju afrohem shtatorit, e që ka qenë një propozim, ankesë, kërkesë për me pas një shkollë të muzikës Vitia, së paku një paralele të ndarë, e si e bëjmë e bëjmë se si e ka bë kamenica. Besoj që e meritojnë të rinjt tanë talentet tanë me ja u dhënë këtë mundësi. Këto ditë ka pas zjarre shumë. Kisha kërku që këto zjarre së paku mirëmbajtjen me bë rreth rrugëve, se aty ku po dhezen nuk po e zgjedhin vendin, sepse mirëmbajtja rreth rrugëve nëpër fshatra nuk kanë qenë në nivelin e duhur, kur dihet se tani ka thatësi, paraqesin edhe më shumë rrezik.

z.Taulant Haxhiu: Përsëritet për të gjithë të pranishmit! I shpreh ngushëllime familjes për vdekjen e ish kryetarit të komunës, z.Nexhedin Arifi, por këtu e kam një vërejtje. Nexhemdin Arifi i përket subjektit politik të PDK-së, dhe aty ka pas një mbledhje komemorativë të thirrur nga kryesuesi i kuvendit, z.Azizi. Nuk ka qenë prezent i pari i Komunës së Vitisë, z.Sokol Haliti, duke thënë që unë jam në udhëtim zyrtar. Ai ka qenë në Mjak, tu dashtë me promovu një rrugë që nuk ka të bëjë me të hiq, është pjesë e qeverisë. Unë kërkoj një shqetësim të jashtëzakonshëm. Ne i kemi hatermbetjet politike, por në vende ku ka mort, në mbledhje komemorativë jemi të gjithë qytetarë të Vitisë. Sokol Haliti ka dashtë me qenë i pari aty me na përfaqësu neve si i pari i komunës në mbledhjen komemorativë të Nexhmedin Arifit. Edhe z.Hasan Aliu, asnjëri nuk keni qenë aty. Kjo është më së paku njerëzore për një ish kryetar komune që ke bashkëpunu ti me të, dhe Sokol Haliti mos me qenë pjesë e mbledhjes komemorativë, nuk është e hijshme për Komunën e Vitisë. Kjo është gjëja më panjerëzore që arrin me bë një kryetar komune. D.m.th, urretjen edhe për së vdekuri e ka paraqit ndaj të vdekurit, ish kryetarit të komunës, dy mandate. Kjo është e turpshme. I nderuara drejtor i shërbimeve publike, kam një vërejtje prej zjarrfikësve të Komunës së Vitisë. Ju e dini që ju kanë ardh donacione 2 kamiona të mëdha për ndërhyrje të shpejt, prej një donatori të Binçes. Po më thojnë për 1200 euro i kemi lanë pa regjistru. Ju po e shifni që çdo ditë po ka intervenime në Komunën e Vitisë, dhe për 1200 euro me u lanë pa regjistrim është e turpshme. Kamionat na vijnë tani se është nxehtë. Nëse nuk i keni 1200 euro, beso që personalisht sot unë i paguj, nuk po bëjë marketing politik. Kam një informatë të rëndësishme, 2 ari tokë kapun me "Home Cake", te ndërtesa që po e bënë vëllau i Sokol Halitit, janë shpronsu në mënyrë të kundërligjshme. Aty 2 ari ju kanë ofru në shërbim sot, një ndër biznesmenave më të mëdhaj të ndëritmit, Nexhmedin Halitit. Unë kërkoj qasje në dokumente zyrtare, se në çfarë forme është bërë shpronësimi aty me 2 ari vend, pikërisht te ndërtesa e vëllaut të kryetarit në ikje, Sokol Halitit.

z.Ali Bajrami: Përsëritet për të gjithë të pranishmit! Nënkyerat pyetja është e drejtuar për ju, në seancat e më hershme kjo që e bëjë këtë pyetje shqetësimi është i ngritur prej shumë qytetarve sa i përket tempererturave të larta dhe mungesa e ujit e keni parashtrur që jeni në negociata për investime milionshe sa i përket investimit në zgjidhjen e problemit të ujit në tere territorin e komunës së Vitisë, më intereson edhe një informata ka lëvizje dhe sikur ka do të ishte shumë pozitive se do të zgjidhet një herë e përgjithmonë problemi i ujit në Komunën e Vitisë.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Drejtori Visar Demiri është tu e përcjell seancën dhe më informoi që nuk ka asnjë kërkesë lidhur me pyetjen tënde që e ke bërë për kompaninë për gurëthyes në drejtori. Të njëjtën kohë ma dërgun edhe lajmrimin për debat publik, ndërsa njoftimi për debata publik organizohet prej ministrisë, por aty shkruan në bashkëpunim me komunën. Pse e kanë shkru nuk e di, mirëpo në drejtori nuk ka kërkesa.

z.Basri Aliu, drejtori i shërbimeve publike: Përsëritet për të gjithë të pranishmit! U ngritën disa shqetësime. Pengesa në fshatin Beguncë ka qenë kërkesë, edhe pse personalisht jam kundër këtyre pengesave, por kemi pas edhe prej vet asamblistave që kanë kërku pengesa që të qiten në rrugë, për shkak mbrojtjes së jetës së njeriut. Ne kemi dhanë një leje të përkohshme, që në sezonën dimërore të largohet ajo, ndërsa nëse mendojnë që banorët e Beguncës i pengon, mund të largohet. Kjo pengesë ka qenë gjithçka me qëllimin më të mirë dhe me

kërkesë të qytetarëve. Sejdi, e përmende shtyllën elektrike, e morra si qëllim. Do të bisedoj me KEDS, si kërkesë do ta dorëzojmë, se ka nevojë. Edhe ne me ndihmu rreth kësaj jemi të gatshëm, me të vërtet kemi disa vende që shtyllat elektrike e pengojnë komunikacionin. Për pritoren tek stacioni i autobusëve. Këto janë kompetencë e ministrisë. Ne i kemi mbush vrimat, se e pashë që minsiria nuk është në gjendje me i qitë në teren. Në territorin tonë, edhe pse nuk është në domenin tonë, i kemi mbush vrimat që kanë qenë në magjistrale. Te zjarret, e vërtet që kohëve të fundit ka pas shumë zjarre. Edhe vet kam qenë nëpër terren. Dua t'i falenderoj zjarrfikësat për efikasitetin që kanë dhanë gjatë këtyre ditëve, sepse nuk është punë e lehtë që të intervenohet brenda ore 3-4 vende. Ishim në fshatin Stubëll, ku pat dëme të konsiderueshme. Prej aty në fshatin Budrikë e Epërme kenë në rrezik shtëpitë. Mandej në Sllakofc. Kështu që, brenda ditës kanë pas mbi 10 intervenime. Sa i përket kamionave, janë në funksion, kanë vepru dhe këto ditë është donacion i konsiderueshëm, që i ka dhuru donatori mërgimtarit, ndërsa me i sjellë i kemi sjellë ne. Ne e falenderojmë donatorin. Regjistrimi nuk është pyetje e mjeteve, është informacion i gabueshëm, por është forma e procedurave, d.m.th shkojnë në homologim. Kërkojnë diçka tjetër. Duhet të kthehet, të shkohet atje. Këtu ka qenë problemi, por edhe pse nuk kanë qenë të regjistruar, i kemi pas në funksion. I ke parë edhe në fejsbuk, që me shkallë të lartë personin e nxerren prej banesës që kish mbetë i ngujum. Përveç një kombi është regjistru, sa për njoftim kemi dhe një veturë në dogan, e cila ende nuk është dorëzuar me arsye, se vetura është më e vjetër se 10 vite, edhe pse është e dedikume për zjarrfikës. Dogana nuk e ka parë të arsyeshme që të na jep, edhe pse ankesat tona kanë shku në Këshillin e Pavarur të Doganave. Ata e kanë kthyer në rishqyrtim landen prapë. Dogana ka vendos njëjtë, jemi në ankesa. Tash shohim se ku do të mbrim. E vlerësimi nuk është mirë me dhanë pa pas informatën të sigurt, sepse në këto raste po përdorin fjalë ofenduese. Kisha pas dëshirë të kenë kudjes kur përdorin kështu informacione.

z.Taulant Haxhiu: I nderuar, ato donacione kanë ardhë kogjo moti dhe ti i qetë me intervenu pa regjistrim. Me ndodhë ndonjë aksident. Qysh një drejtor deklaroi që në intervenim i qoj pa regjistrim. Zjarrfikësat mua ma paraqiten si problem. Para se me ardhë në seancë, ata thanë që rrinë në parking për 1200 euro. Nuk mundemi me to, për shkak që janë të paregjistruar, dhe unë morra si informatë, ndërsa ti po thu ato kanë lëviz pa regjistrim. Me ndodh aksident, kush e merrë përgjegjësinë?

z.Basri Aliu, drejtori i shërbimeve publike: Unë e marrë përgjegjësinë kur është në pyetje shpëtimi i jetës së njeriut.

znj.Arta Ajeti, drejtoresha e DKA-së: Përhëndetje për të gjithë të pranishmit! Pata pyetje nga këshilltari komunal, z.Sejdi, rreth shkollës së muzikës. Shkolla e muzikës në vendin tonë është jo vetëm e dëshirueshme, por edhe e domosdoshme për disa arsye të rëndësishme, plotësisht me vend, ku e kemi zhvillimin e talenteve lokal, edhe pse ende nuk është hapur, për arsye se mendohet të jetë në objektin e inkubatorit, ku ende nuk është përfunduar. Dhe kjo është arsyeja, edhe pse kam ndarë kodin për pajisje muzikore përcjellëse, që janë ato në momentin që të përfundon inkubatori, edhe pse e dimë që kemi kogjo sfidë, për shkak të përmbartjes nuk mundet të përbyllet. Unë e përkrahi dhe do të jem iniciatori që të hapim 1 apo 2 klasë të muzikës. Fëmijët tanë, talentët tanë vrehen, dhe përmes OJQ-ve që i kemi në komunën tonë, të rinjë mos të na shkojnë në Gjilan dhe Ferizaj, dhe komuan jonë ta ketë hapësirën tonë.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës: Më lejoni të ju përhëndes. Të nderuar të pranishëm! Kam bërë përpjekje t'i shënoj të gjitha pyetjet, edhe ato të adresuara për kabinetin e kryetarit edhe të drejtorave, megjithatë më vjen mirë për shqetësimet e ngritura nga ana e juaj. Te varrezat e familjes bilalli, asafitimi i rrugës dhe shumë të tjera që janë të shtruar në këtë drejtim të pa përfunduar të filluara tu fillu dhe te Nexhati që e përmendi dhe te Jakupi unë besoj po perseriten qdo seancë të njëjtat se e njeta problemet që është se janë të pa përfunduar por është qështja e kontratës kolektive dhe egzekutimi i mjeteve të cilat i lenë në gjysë kemi telashe rreth këtyre qështjeve, tek rrugët regjionale që e shtrij iliri dhe kërkoj mundësin e një dërgimi të një shkrese nga ana juaj unë besoj që edhe ata ekan mbikëqyrës e vet e shiqijn por me ngrit zërin besoj që është mirë.

z.Basri Aliu, drejtori i shërbimeve publike: Para 3 dite kemi pas në takim te kryetari menaxherin i cili është prej ministrisë lidhur me mirëmbajtjen e rrugëve, dhe kemi ngrit si shqetësim, dhe ai na ka siguruar që brenda një kohe shumë të shkurt do të dalin në teren, do t'i elemnojmë këto.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës: Tek shpronësimi i parcelës në Letnicë të ujit që e ngjrit Jakupi. Po, është një realitet, por nuk ka probleme rreth shpronësimit aty. Është përhap një dezinformatë, me çka e kanë nifotua edhe zyret e OSBE-së, ministrinë, "Hidromoraven" dhe ambasadën kroate, dhe unë vullnetarisht kam qenë në atë takim. Problemi aty është shtrur se, reken e Letnicës po dojnë me marrë krejt. Këtu është shqetësimi. Dhe tash kanë qenë të programit "Flows" dhe të "Hidromoravës", dhe kam qenë unë, jemi mundu, e kemi spjegu, se fjala është për ujin i cili vjen në fabrikë dhe kapaciteti i fabrikës së ujit nuk është i mjaftueshëm për me bë pastrimin e tij. D.m.th nuk intervenohet te prurjet e ujit, por fabrikë e re, rezervuar i ri, dhe pjesë tjera përcjellëse çka janë te fabrika, dhe vlera e saj është diku rreth 6 milion. Unë qysh e di, tani është edhe përfundimi i afatit të ankesave. Pikërisht nga kjo unë jam zotuar që, një takim për kërkesa tjera që i keni ju, do të mbajë dëgjime buxhetore në Letnicë, që do të jem sot prej orës 1, por jo për këtë temë, këtë temë e kanë spjegu ekspertët e Ministrisë së Ambientit, edhe të "Flows", dhe të "Hidromorvës". Për zjarrfikësat nuk kemi ndarë mjete, kemi bë përpjekje ndonjë ujë, se ata përveç pagës e kanë edhe pjesën e rrezikshmërisë. A është tu ju pagu nuk e di, por e di që një regjistër ma bijnë, gjithmonë e kam nënshkru për orë shtesë, për shkak që këto ditë, në rast se ka heronj të punës janë ata, me të vërtet janë ballafaqu përball zjarrit. Rruga në Drobesh përball xhamisë së fshatit. Liridonë, ndoshta në këtë rast nuk mund me ti dhanë detajet, për shkak se duhet me shiku a është pengesë kontrata kolektive apo çka është, diçka ka ndodh. Qashtu është fjala edhe për rrugën "Skender Salihu". Te Sokoli do të ndalem, më detajisht Zyrën e Informimit e paskemi këtu, që si po vika prej ministris ashtu dhe e ka publiku. Nëse bëhet fjalë për Terpezë, pse tubimi me u mbajt në Pozheran. Janë çështje që Terpeza e kanë shtrur. Edhe më herët e kemi pas ndalu. Ai ju ka drejtu Drejtorisë së Urbanizmit, jo në kohën e Visarit, por Drejtorinë e Urbanizmit e kanë dhanë një dhënie të informates lidhur me të, se me plan zhvillimor nuk është e parpame. Në bazë të saj ministria e ka dhanë një pëlqim dhe ka bë një thirrje për debat me qytetarë. Kur pyetëm kenë e keni kontakti në komunë, mjerisht ata kanë thanë e kemi kontakti një person që nuk është një punëtor i komunës, as këshilltar komunal, por përfaqësues i kompanisë, që për mua është gabim i madh, se ai është person profesional, por që ka interes dhe nuk duhet me i caktu ai takimet, por duhet me caktu komuna aty ku preket territori. Besoj që nesër do të bëjë përpjekje me detajizu, dhe takimin ta qoj në Terpezë. Unë sot kam bisedu edhe me Sokolin, me shiku se cilat janë dobitë apo dëmet e kësaj pune. Majlinda, unë e di se çka do të themë ty, nuk të vjen mirë, por do ta themë realitetin, se jam obligativ. Në radh të parë, nuk po më pëlqen që thua Sokol, se është kryetar. Unë kurrë jashtë LDK-së nuk e kam votu askënd, por kurrë as kryeministrit Albin Kurti nuk i kam thanë Albin, por as Hashim Thaqi, jo me emër, por kryeministër, se duhet të mësohet, është kulturë politike. Por edhe kryetarit të ndërës tash që u përmend. Merri ingjizimet, kurrë nuk i kam thanë Nexh, por i kam thanë kryetar, se është edukatë. Se shumë po flet rreth shkeljes së ligjit. Më habit kur ti si këshilltar e kuvendit komunal, kur të tjerëve nuk kam arsye mu ju thanë se nuk po thonë që e ke shkel ligjin. Ti i ke bë 5-6 pyetje që e ke shkelë rregulloren që e ke aprovu, që ta ka propozu qe ky kryesues, që ke drejtë veç 2 pyetje m'i bë, e i bëne ka 10. Po ti përmendi se po shitesh shumë si mbrojtje e ligjit, e ka të hecësh ti e shkelë pa ndalë hiq. E kryetari për një vonesë 1-mujore të cilët e ka vonu informaten, ti po thu e ka shkelë ligjin. Për çudi, por hala më e çuditshme është, thave edhe fyese. Unë e mbajta takimin me këta këshilltarë të subjektit tim të partisë politike, dhe me drejtorat, jo veç unë, por as këta as se kanë sha, as se kanë fy. Kemi diskutu dhe kemi ardh komod. Nuk e di që ka fy dikush. Po thu, ti pe dishe që si funksionon Sokoli, nuk po e di. Unë bre që 30 vite tu nga me ta, ti po më vjen mirë që paske mërri aq dhe po i dishe njerëzit si funksionojnë, por me pas ditë nuk e kishe lanë me u bë kryetar, por a pe sheh që nuk e din. I thave kryesuesit, mua nuk më interesojnë procedurat. Në këtë anë kërkon respektim të ligjit, në anën tjetër mua nuk më bajnë përshtypje procedurat. Ty nëse nuk të interesojnë, ti atëherë e shkel ligjin. Aq është kontraverse, është problem me të përcjell çka thu. Për kubzat te xhamia. Besoj që drejtori i ka marrë shënimet. Raport thu të kryetarit, borxhe, dallavere. Pse po e përdor këtë dallavere? Qysh dallevere? Ti duhesh me pas argument, fakt, sepse kemi një prokurori. Unë e di që ju edhe në prokurori nuk shkon me dhanë deklarata, se nuk shkon ai i pari i juv. Nuk e kem problem, por drejtor, ajo është që e ndanë drejtësinë, unë nuk muj. Nexhat, besoj që krejt është çështja e kontratës kolektive. E di që këtë çështje e ke ngritë dhe e ke pas atë ndjeshmërinë ndaj atij personit hendikep. Edhe kryetari ka pas gatishmërinë. Binduni, në rast se ju këto 4 vite jeni knaq si këshilltar prej kuvendit

komunal, për mua gjatë jetës time 62-vjeçare, ka qenë 4-vjetori më i vështirë i jetës sime. As në okupim nuk e kam pas më të vështirë, se veç qohesh në mengjes, vjen në punë, thirrë dikush prej financave, na e murrën parët. Tash është gjendja reale jo vetëm në Viti, por në të gjitha komunat. Te uji i pijes, se jam marrë shumë me këtë çështje. E kam thirrë drejtoreshën, më ka njoftu që e ka dërgu në Zyre të Prokurimit. E di se disa lagje të Sllatinës qysh e kanë bërë atë prerjen, komisioni përveç aspektit elektrik, janë edhe disa intervenime që duhet me i bërë, dhe në momentin e përfundimit të punimeve, besoj që do të kenë dhe ujë të kontrolluar, ujë të pijes. Taulant, me krejt respektin, është mirë me ditë kur e merrë informacionin. Lidhur me këto që po i themë, nuk i bishtojnë asnjë. Në ditën që ka ndodhë, unë kam dëgu prej Sokol Halitit, për shkak që edhe unë kam pas një rast të vdekjes. Fejsbuki e kish qitë, por unë nuk e kam parë. Nuk kesh tu tregu, por pasi pe lyp informacionin, mua më ka vdek gruaja e mikut, dhe ka qenë dita e parë, pritja ka qenë. Kur e kam marrë informacionin, ka qenë ora 12 e ditës, e kam marrë prej kryetarit që përgatitu, një kurorë dhe një fajlim për me marrë pjesë në vorrim edhe në mbledhje komemorativë. Kam thanë, në mbledhje komemorativë nuk muj për këtë arsye, por në vorrim po. E kam thirrë Haxhi Qerimin, e kam pyet për kohën e varrimit. Kam kontakti edhe me djalë e Nexhës. Këto që po i ceku nuk janë mirë me u cekë, por po kërkon, dhe i kam thanë që ai ka vdek si kryetar komune, mandatin e fundit ka qenë, duhet me u përcjell nga institucionet komunale. Unë kam gatishmërinë me ardh me mbajt fjalën mortore dhe me vendos kurorë. Dhe më ka thanë je i mirëscardhur, dhe kur e kam pas gatishmërinë me shku në vorrim, 6 herë kisha ardh në mbledhjen komemorativë. Dhe tash kush është dashtë me organizu mbledhjen komemorativë. Ju e dini që keni gabu rënd, se është dashtë dikush tjetër. Janë shpronësuar 2 ari tokë. Ti e ke shumë lehtë, Drejtoria e Gjeodezisë, Kadastrit është aty, shkon, ki të dretjë me pas qasje në dokumente zyrtare, e shikon a është shkel ligjin. A është e vërtet ajo çështje dhe a kanë punu konformë ligjit, nuk kanë punu konformë ligjit. Këtu e ke policinë, gjykatën, prokurorinë në Gilan. Sejdë, unë e kam thanë edhe në seancën e kalume që, komisioni është i formuar, deri ku ka ardhë në aspektin procedural nuk e di, i di brengat e tyre, e di që ka qenë një takim mes kryetarit, komisionit dhe Mergjanit më duket. Deri ku nuk e di. Ali, investimi do të jetë afër 6 milion. Unë kam thanë dhe do të themë edhe sot, ishalla e merr një kompani e përgjegjshme, që besoj e përcjellin ata. Unë besoj që duhet të bëhet në Viti një analizë, ai kapacitet i ujit të cilin e fitojmë në Letnicë, përveç Vitisë edhe sa lokalitete do ta zgjidhin problemin e ujit. Dhe do ta kemi më të lehtë mbulueshmërinë e fshatrave të mbetura. Nëse ai lokalitet që ka pas me përfshi Stubllen, e ka Ramnishtën, Vitinë, Smirën, Verbanin, Drobeshin, Gërmovën, dhe kanë furnizim të mjaftueshëm, dhe mund me u kyq ndonjë fshat tjetër. Unë besoj tani e kemi indentifikimin shumë më të lehtë, dhe zgjidhjen e ujit të pijes më të lehtë.

z.Taulant Haxhiu: i nderuari nënkryetari i komunës, me gjithë respektin, varrimi është akt i rëndësishëm, por nuk është zyrtar. Një nënkryetar i komunës për atë po e njohim krejt, një Hasan Aliu për 25 vite pjes aktive e politikës vitiase, mos mi nda 45 minuta kohë për një mbledhje komemorativë për një ish kryetar të komunës, me ardh aty prej Gilanit komandata, Ahmet Isufi, kryetari i Komunës së Kaçanikut, Elez Hanit, Mehmet Ballazhi kryetar i komunës, Kamenicë ish kryetar i komunës Nevzat Sinani. D.m.th mos me qenë prezent aty njerëzit që na përfaqësojnë neve. Unë mundem me pas me ty kundërshtime politike, por ti deri me 12 tetor je nënkryetar i Komunës së Vitisë, edhe kryetar i jemi, edhe kryetari Sokol Haliti, marrë është kjo mos me marrë pjesë. Kjo është marrja më e madhe që e ke bërë në politikë, se të njof shumë më burrë se Sokolin. Për këto 2 ari tokë. Unë e kam një informatë, një burim të rëndësishëm. Unë uroj të mos jetë ashtu, por nëse është, dije se dikush ka me shku në vepër penale. Do zhvatës tu të zyrës tënde që kanë qenë pjesë, Taulant Haxhiu do t'i shkoj deri në fund kësaj pune.

znj.Majlinda Shabani: Dua të diskutojnë qasjen që pata sa i përket raportit të punës, se e pashë që shumica prej juve reagon, edhe konsiderun të pahijshme qasjen time, mirëpo nuk e konsiderun të pahijshme faktin që sot mungon dokumenti që është me rëndësi, duke u ndërlidh me faktin që, në secatat e kuvendit komunal parimisht dhe në parim i mbajmë për interes të qytetarëve të Komunës së Vitisë. Sot kemi konsideru si për çdo vit që, ai ka qenë raporti më i rëndësishëm që është dashtë me diskutu. Pyetja ime është që, a mendoni që nuk ka mujtë me bërë gati një raport të cilën, se për çdo vit pothuajse e kanë sjellë të ngjajshme. A po e mendoni faktin që, ndoshta nuk i ka konvenu Sokol Haliti me pru raportin për me diskutu, dhe tash ne nuk jemi për me i shku atij përshtati

se si i konvenon. Ne këtu jemi për me i mbrojt interesat e qytetarëve. Nënkyetari po më thotë mua se, unë po i qasem atij Sokol. Për mua ai nuk është kryetar, por nëse po don me i thanë kryetar, unë mundem me i thanë kryetar në ilje. Nënkyetar, ti e dinë që ty sahere tu kam referu, tu kam referu edhe i nderuari nënkryetar, sepse ju respektoj për pozicionin që ju e mbani, dhe korrektësinë që ju e keni tregu ndaj neve për vite të tëra. Nuk mundem unë me tregu respekt ndaj një personi në fjalë, që përpos faktit që na injoron komplet si kuvend, nuk vjen në seanca. Në mënyrën se si është tu vepru dhe në opinionin publik, kjo është shqetësuese. Fakti tjetër, ligji dallon me rregullore. Rregullore kemi pas shumë rast në kuvend komunal, ku i kemi shkelë, sepse kanë qenë në intres me i kalu disa procedura të cilat është dashtë me i ndërlidh me faktin që kanë qenë në interes të qytetarëve të Komunës së Vitisë. The i keni mundësu Sokol Haliti me u bë kryetar. Nëse isha pyet unë, ai kryetar komune nuk ish bërë, por detyra ime për këto 4 vite, unë me ju tregu qytetarëve të Komunës së Vitisë, që kryetari që ata e kanë votu, është kryetari që pikërisht juve ju ka mashtru. E përderisa ky kryetar del kandidon pa pikë ftyre, pa pikë marre, me premtime të njëjta, për mua është tepër e rëndësishme, jetësrore në këtë moment që jemi, me dëshmu që, ky kryetar duhet me u ndëshku prej qytetarëve të Komunës së Vitisë, sepse është koha për me u ndëshku.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës: Këshilltare, the se ty të respektoj se na ke respektu. Vetë prezenca ime e preznaton dhe kryetarin Sokolin. Ju e keni pas vazhdimisht, sjellni Zyrat e Kryetarit. Ne i sjellshim. Kur i prushim zyrat, ju asnjë pyetje. Unë po mendoj që elektorati juve nuk janë si ti, se nëse janë si ti, unë sot ja uroj Sokolit edhe një mandat 4 vjeçar. Kjo gjuhë, kjo frikë e jotja deri në palcë, pse është kandidu ai. Unë kandidatit të juaj ja urova, e takova, urime shëndet, këto i ka pluralizmi. Jo, kjo frikë e juaja, pse është kandidu Sokoli, vetë tregon, se vetë kandidimit të tij, aq i frigohesh që ai po fitojka sërish.

z.Nexhat Halili: Nënkyetar, është e vërtet që ke pru inxhierat dhe zyrtarin e prokurimit këtu, mirëpo pyetjet të cilat ju kanë bërë inxhierave dhe zyrtarit të prokurimit, përgjigjet nuk kanë qenë në nivel. Përgjigjet kanë qenë të anashkalaura, deri sa te administrita e shërbyesve civil të administartes kemi qenë në gjindje me i nda 3500 euro për sindikatën e tyre, dhe nuk besoj që nuk ka mjete për me i nda sidnkates së zjarrfikësve. Një pjesë të mjeteve, për shkak gjendjes që kan tash. Te uji pijes. Në bazë të planifikimit të prokurimit, është parapa që, kjo procedurë për ujë të pijes të filloj me 17.03.2025, prej mujit 3, tash jemi në muajin e 7, ju lutem sa më shpejt filloni këto procedura.

zn.Liridona Bislimi: Te çështjet që i ngrita. E para, po filloj me atë pjesën e trapit. Ndoshta po të doket çështje minore, por mandej tana përgjigja që po i jepet, po të jep njëfar diskutimi, njëfar efekti që këto edhe për çështjet më minore nuk mendohet dhe diskutohet më lartë. Unë mendoj që Komuna Vitisë ka disa eksperta të komunikacionit, që qohen dhe bëjnë një analizë të thjesht, por edhe pa pas eskeprt, veç me sy mi pa, është e logjikshme që në kthesë dhe në përpjetze, trapi nuk ka efekt. Tash unë e di përgjigjen që ma ke dhënë, që jemi tu e bë për të mirën e qytetarëve, por mandej duhesh me shiku pasoja, përderisa qaj veprim më shumë ka pasoja. Mua nuk më duket shumë e hijshme me u vepru në këtë formë, dhe unë mendoj që është larg me prit deri në dimër, për shkak që edhe stina e vjeshtës paraqet rrezikshëri në përpjetze. Tash nëse ndodh ndonjë aksident, mos të qohemi me i bë veprimet e menjëhershme, se pasojat munden me na kushtu neve si institucion. Nënkyetar, unë ti bëra 2 pyetje për 2 rrugë të ndryshme me lokalitetet të ndryshme, dhe ti më duket ma dhe përgjigjen. Në 1, qysh ma jep ti këtë përgjigje mu, përderisa prej personave kompetet të rëndësishëm, prej një drejtorit, atij fshati i bëhet premtim elektorat që, po ka me ushtru në anën tjetër për këtë rrugën në Viti, që po flas është vetë drejtori Basriu që ka thanë, po ka me u kry, hynë kjo rrugë 2 herë në implementim dhe nuk implemetohet. Tash në fund jepet një përgjigje që ndoshta ka kontest gjyqësor, por ne po flasim për një temë që ka fillu kërkesa, prej 2018 nuk jemi tu fol. Që 8 ditë është periudhë e gjatë dhe në fund me ju dal qytetarëve me një përgjigje, që valla më tha nënkryetari, ndoshta është kontest gjyqësor. Çka me ju thanë banorëve të fshatit Dorbesh dhe banorëve të asaj rruge. Sipas teje, me jep një përgjigje kontrete, ata kanë qenë dhe me kryetarin në takim. Po, është e kryme. Pse kryetari nuk ju thotë një përgjigje taman si duhet.

z.Basri Aliu, drejtori i shërbimeve publike: Për cilën rrugë ke fjala?

zn.Liridona Bislimi: Është rruga "Skender Salihu" në qytet të Vitisë, rrugës për Kllkot, para se me mri te restaurant "Roza", ish restaurant "Lindi". Janë afër 20 shtëpi. Më kanë thanë që, para 2 viteve që kanë pas takim dhe me juve, dhe ju keni premte që ka me u përfundu rruga. Kjo kërkesë është prej 2018.

z.Basri Aliu, drejtori i shërbimeve publike: Permi restaurant "Roza" është e shtruar me asfalt. Ajo rrugë që po thu ti ka fillu dje tu asfaltu, mundesh me shku me verifiku. Permi restaruant "Lindi" është e asfaltume. Përveç një pjesë 100 metra janë brenda, edhe ajo tani me këtë kur të kryhet kalojnë në pjesën tjetër.

z.Basri Sylejmani: Deshta me u ndërlihd pak te kryetarët e partive. Zotri Bekimi, unë nuk mundem me i thanë Bekimit, Bekim. Në qytet unë i thamë z.kryetar, edhe pse është kryesues. Edhe kryetarit të juaj i thamë z.kryetar. Ju më së miri është me ja lan Sokolit emrin kancer, se ju është bërë kancer.

z.Jakup Demiri: Prej nënkryetarit, te puna e trotuareve e morra një përgjigje. Unë dhe qytetarët, që edhe kontarta kolektive me një formë pajtohet, nuk pajtohet, unë nuk jam tu fol për projektet të këtij viti ose vitit të kalum, unë po flas për porjektet të cilat i kanë kalu të gjitha procedurat e dinamikave kohore të punimeve. E kam pru me shifër, 27 projekte me shifër. Unë i kam pru vitin e kalum që i kanë tejkalu të gjitha procedurat. Jemi tu fol për trotuaret që janë nis para 4 viteve, por janë nis pa buxhet, pa planifikim në kohë fushate, por ato duhet me u kry. E dyta, sa i përket pyetjeve që duhet 2 e 3, shumë në rregull jemi, që unë besoj i kam 12 pyetje prej qytetarve, këto i zgjidha. Unë kam pyetje prej banorëve, rrugës me kallderm, që del një ndërtues bënë gjithçka, hek kubza, vijnë dhe natën kamionat punojnë, shprazin, njerëzit në gjumë. Nëse ka leje ai për me i hek ato kubza, a ka leje objekti, tash është në pyetje, se edhe objekti nuk ka leje. Si e murr lejen për me i hek kubzat. Shumë paradoksale. Është komuna jonë, e tana këtu e relativizoj, ja ligji, rregulli, por këtu nuk ka ligj. Prap po thojnë informata e kryetarit. Me gjithë rsepetin për të gjithë juve, se ne jemi njerëz, u dashtë me ardhë këtu. Ndërsa për ujin e pijes. Mendoj që, 27 apo 24 fshatra tash 4 vite kanë qenë me ujë të pijes. Janë filmat hazër, bile nuk keni nevojë për fushat hiç, veç ato i shfaqni. Kam qenë edhe në debat me nënkryetarin në Plus Televizion, dhe Taulani ka qenë, që 24 fshatra janë sot me ujë të pijes. Nënkryetari e ka thanë, e ku janë ato fshatra. Unë këtu e kam të shkrume, qytetari në banesë jeton. Në këtë zhegun 40 grad nuk ka pas ujë 3 ditë. Ishalla kryhet, mshilet ky kapitulli i ujit. Nënkryetar, për trotuaret a kryhen këtë vit apo nuk kryhen këto trotuare? Janë nis që 4 vite, nuk kanë të bëjnë me kontraten kolektive.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës: Nuk guxoj me të thanë kryhet, se që tani keni me pas një propozim vendim që e morri kryesuesi me shti rend të ditës. Dje kam pas takim me DEMOS-in, i kemi 105 mijë euro që duhet me ja kry obligative, nuk u kry puna nga grandit i përfomances, dhe ai kërkoj si ti mund me i kthy apo nuk mund. 2 herë i kemi ba ka 105 mijë edhe na kanë marrë. Në pritje i kemi edhe 129 mijë sipas drejtoreshes, vendime. Te përmbaruesi sa janë në procedurë nuk mundem me i ditë unë, për me afat nuk e di, se nuk varet prej meje. Ti mund me thanë që nuk ka ndiku, por ka ndiku. Ndoshta ka qenë 1 vit pas pandemisë, që po thu 4 vite që janë nis. Ndoshta ka qenë çështja rritje si e quajshin ekonomistat e vlershmërisë, punës, në përputhje me disproporcion mes kotratav. Ke edhe ajo një shtymje dhe pat shumë që e lanë punën, nuk e kryten. Gjithsecili e ka kontratën e vetë, dhe në kuadër të saj disave me siguri kemi mi dhanë përparësi, por mem lidh me afat që në këtë afat e kry kur nuk i kemi paret është problem. Ka qenë Majlinda në debat me qytetarët, kam thanë, unë po bisedoj për mbi 2 milion për investimet kapitale, por ndoshta me detyrimet që i kemi me kompanitë nuk e kemi asnjë. Në rast se nuk i bënë rimbursimin qeveria nga niveli qendror, e kemi këtë gjendje. Nuk është në Viti, por në të gjithë regjionin. Kjo gjendje nëpër komuna donë tretman në nivel qendror dhe zgjidhje të problemit. Nuk po mundem me i thanë kush e ka gabim, se kontratën kolektive e ka nënshkru Hashim Thaqi, e ka vazhdu Avdulla Hoti, jemi tu e pagu ne tani, por nënshkruës komuna nuk është. A kemi tentu me bë kod të veçant, kemi tentu, por nuk na kan lanë. Mu nuk është tu mu dhimt që paret i kanë marr mësuesit, se është e drejtë e tyre, mua më dhimbet që për 26 euro Jakup kemi pagu 290 euro përmbarues. Pse e kanë toleru këtë gjë, a kanë mujtë me ndërpre, mem pyet mu, po, dhe ka plotë jurista që thojnë po. E kish marrë kontratën kolektive me mësuesit e Vitisë, dhe Komuna e Vitisë i ka kaç, qiti në kod, paguaj.

z.Jakup Demiri: Nënkryetar, pajtohem me shumicën e gjërave, por ne si Komunë e Vitisë, tu nis prej KAB-it si dokument, edhe vitin e kaluar edhe këtë vit, shikoj kornizat afatmesme buxhetore të komunave tjera edhe

komunës sonë, që i ka defektet jashtëzakonisht tëra viteve të këtyre telasheve. Nuk është që kërkoj vetë, edhe si grup parlamentar, listën e investimeve kapitale edhe listën e projekteve, për shkak që kemi projekte që 4-5 vite pa kry. Po ki projekte që janë nis dhe po përfudon, ajo po jet nënstop. Unë po kërkoj, nëse ka mundësi qata me qitë një ekip të punës përmes shërbimeve publike, me i mbyll disa gropa, se ka pas lëndime dhe të pleqve dhe të fëmijëve. Ose nuk bëhet ajo, ta dimë ta marrim një aksion në vetë të i përfundojmë. Ke vend që i ka mbi 70 centimetra gropë.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Ka shumë projekte të cilat munden mos me u kry për shkak të mjeteve që janë marrë, mirëpo Jakupi e pat fjalën për projektin që 3 vite, që kemi ngritë disa here, trotuari në Smirë, në mes trotarit është lanë gropa.

z.Jakup Demiri: Për me ta vërtetu, unë e kam pas një takim në Smirë, që palestra shkollore në Smirë. Ajo është buxhetu në vitin e kalum, po ne e kemi ditë që ajo nuk është muhabet, se njerëzit e dinë që kanë pas me u ndërtu këtë vit.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Materialin e keni marrë me kohë, hapi debat për rendin e ditës. Para se me hy në rend të ditës, zakonisht në seancën e korrikut e kemi edhe në planin e miratim. E dimë që 2 herë në vit vjen materiali i informatës së Kryetarit. Jemi konsultu, nuk është e gatshme, mbetet për seancën tjetër. Para se me hap debatin, unë i kam 2 kërkesa nga drejtoritë, propozim vendime **1. Propozim vendim për aprovimin e buxhetit të participimit nga fermerët përfitues. E dini që participimi që ndahet, fermerët përfitues e kanë obligim 20% të participimit në pjesën e përfitimit që kanë, dhe kjo nuk mund të participohet nëse nuk lejohet me kuvend. 2. Propozim vendim për bartje të të hyrave vetanake nga një projekt në projektin tjetër.** Tregoj nënkryetari, kanë pas takim me DEMOS-in. Unë kam pas më heret takim, është një obligim që ka mbetë, paret që i ka dërgu DEMOS-i, që kanë qenë për projektet e përfitime, me të njëjtat para janë pagu projektet tjera. Për shkak kodeve që janë përzi, ne është dashtë me pagu drejtpërdrejt atë projekt. Tash janë pagu me pare të DEMOS-it projekti tjetër, sepse ka qenë me kodin e njëjtë që hynë, dhe të hyrat nga ministria. Ne duhet me ja kthi paret DEMOS-it, se me pare të DEMOS-it e kemi bërë pagesën aty. Në DEMOS figuron si obligim që e kemi. Hapi diskutim tek rendi i ditës.

R e n d i t e

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e gjashtë e kuvendit komunal.
2. Pasqyrat Financiare të buxhetit Komunal për periudhën janar-qershor 2025
3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen në diskutim publik projekt planin e punës së Kuvendit Komunal të Vitisë për vitin 2026.
4. Informatë nga DKA-ja, përfundimi i vitit shkollor 2024/2025.

z.Jakup Demiri: Ne si grup parlamentar këto 2 i mbështesim, por prap po lidhem te raporti i kryetarit, por në KPF neve na u tha që raporti është gati. Unë e pata një kërkesë që, të paktën 7 ditë në ti ka afat kohor, që të analizohet, por edhe potencova që është mirë edhe në KPF me ardh, se nuk e ndalon ligji e që nuk është përgatit kjo. Unë themë që nuk është bërë me qëllim, se është vit zgjedhor. E dimë që jemi në muaji korrik, në gusht është pushim. Tash me ardh në shtator, zgjedhjet janë në tetor. Çfarë efekti ka ajo punë. Të gjitha punët tjera janë më të pa rëndësishme për mua si asamblist sesa raporti i kryetarit qetu me diskutu. Kam dal në teren dhe i kam shiku hapësirat gjelbruese që i bëjmë Komuna e Vitisë. Mundem me thanë që, 60% e drunjëve dekorativ janë tharë pa përgjegjësi. Dilni këqyri, që nuk del ajo jap përgjegjësi penale para juve. Kqymi fotografitë kur i keni publiku, ka pas ulse, sot nuk e di a është ajo hapësirë a nuk është. Në këtë gjendje janë investimet e komunës sonë, për këtë duhet me diskutu. A ja vlen apo nuk ja vlen, a me i ndryshu investimet, këto projektet e hapësirave gjelbruese prej kapitale me i nxjerrë te shërbimet, se ai nuk është beton, e qet dhe në rregull jemi. Në fund të fundit, pse i mbjellim ne me ja dhanë tenderin ndokujt apo përnime me i shërby qytetarët me u dokë më mirë natyra. Ne komplet vitin e kemi pas shpall vit të ambientit. Kur t'i bëjmë investimet, tani dalim qesharak me vetin.

z.Musli Neziri: Mendoj që, obligim ligjor është sjellja e raportit të kryetarit. Zakonisht kështu e kemi pas, ne nuk kemi qenë në KPF, nuk i kemi këto informata që i tha Jakupi, por mendoj që më shumë është ikje e përgjegjësisë së kryetarit që i takon ta sjell raportin 6-mujor për punën që e ka kry. E dimë që është vit zgjedhor. Kjo është bërë e qëllimshme, prandaj nuk është mirë kjo mos përgjegjësi.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Veç ta dini që, në KPF veç ka pas pyetje dhe është diskutu që materiali me ardh 7 ditë para seancës që vjen gjithë, përndryshe në KPF nuk vjen informata e kryetarit.

znj.Majlinda Shabani: Faleminderit që më keni përkrah në këtë drejtim, me bë kaq shumë diskutim në raport me informatën e kryetarit. Si në fillim e pata këtë kritikë, se për mendimin tim, seanca nuk ish dashtë të mbahet sot po me u shty deri sa këta kishin qenë të gatshëm, apo që nuk paskan dashtë me pru raportin e punës, megjithatë diskutimin tim e përfundova, se e kam ditë qysh në fillim sakt që s'kanë dashtë me pru, se nuk i ka konvenu kryetarit, mandej edhe merrë kritikën. Ai ish dashtë me qenë prezent, ai nuk po don me qenë. Këtu është problemi. Dua me u ndërlidh te pjesa e propozimit për aprovimin e buxhetit të participuar nga fermerë përfitues. Ne e dimë që jemi dhe kemi qenë vazhdimisht mbështës dhe përkrahës që duhet me u subvencionu dhe me u përkrah fermerët e Komunës së Vitisë, ku unë kam kërku dhe disa forma të tjera subvencionimi, por megjithatë nuk kanë gjetë implementim. E di që kjo duhet me kalu. Unë kam vetëm një shqetësim dhe kritikë që e kam ni prej fermerëve, që shumica e subvencioneve që janë dhanë këtu, që i kemi në listë, janë dhanë për mbështetës dhe përkrahës të LDK-së. Drejtor, kam informacion të sakt që, Sokol Haliti ka ardh me listë të njerëzve dhe e ka dorëzuar te ti, që duhet me qenë fitues të subvencioneve, dhe për mua kjo nuk është e drejtë karshi fermerëve që bëjnë punë dhe që e meritojnë subvencionim me marrë. Dhe ky nepotizëm duhet me u ndalu.

z.Naim Pira, drejtor i bujqësisë: Të bësh kritika të tilla, po e themë me sinjeritetin më të madh, jam qe 4 vite drejtor i bujqësisë, kurr kryetari ndërhyrje nuk ka pas. Dhe një po ua thamë, po ja u jap fjalën e nderit që, 10% e fermerëve nuk i njoft, dhe kurrë nuk më ka ba përshtypje se i cilit subjekt politik është. Për mua është e rëndësishme me qenë fermer dhe me meritë. Në vetëvete lëndohem ndoshta pa të drejtë, po ua bëjmë ndokujt. I tillë jam, akuza të tilla nuk ka kuptim me bë. Unë e kuptoj që është fushatë zgjedhore, i kuptoj asamblistët që kanë pretendime me u zgjedh prapë, normale është, por nuk mund me kuptu dhe me pranë këtë, se është ofendim për drejtorinë time, se me përkushtim të madh kanë punu në përzgjedhje të listave. A ja kemi qëllu 100%, jam i bindur që askush nuk mund me ja qëllu 100%, por gatishmëria me punu me nder dhe përkushtim, pa bërë klasifikime të tilla, të jeni të bindur se ka qenë dhe është. Kisha kërku mirëkuptimin e juaj që të kalon kjo pikë e rendit të ditës.

z.Ali Bajrami: Unë po ndërlidhem me këto 2 propozim vendime që na e sjelli sekretaria. Është mirë që si kuvend t'i kalojmë, mos të bëhemi ne pengesë që mos të perfitojnë këta fermer në bujqësi, dhe këtë propozimin që kemi për ridestimin e mjeteve, janë obligime procedurale ligjore. Ne si grup i LDK-së i mbështesim 2 propozim vendimet.

z.Nexhat Halili: Po ndërlidhem te propozimi dytë, bartja e mjeteve prej një projekti në projektin tjetër. Mjetet të cilat pretendoni që janë prej grandit të performancës, në bazë të një dokumenti që e kam nxjerr te DEMOS-i, figurojnë grandit performancës i 2021-it, po që realizohet 2023, janë 105 mijë e 109.47 euro. Ju tani keni bë kërkesën 75 mijë euro për bartjen e këtyre mjeteve. Te rruga Sllatinë-Viti, ne e dimë që pranimi teknik nuk është bërë, tash mjetet i merren këtij projekti e delegohen në projekte tjera. Nuk e shof të arsyeshme. Ky dokument është dashtë me ardh me kohë dhe me shku në KPF, që me analizu këtë dokument, mirëpo ju i bini dokumentet veç për momentin, dhe për momentin gjithçka që të votojsh, që është me mjete financiare duhet analizë.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: A jeni që propozim vendimi për aprovimin e buxhetit të participuar nga fermerët përfitues të hynë në rend të ditës. Pra, me të gjitha votat pro, pa asnjë votë kundër, hynë në rend të ditës. A jeni që propozim vendimi për bartjen e të hyrave vetanake nga një projekt në tjetër të hynë në rend të ditës? 11 pro, 0 kundër, 7 abstenime, dhe kjo hynë në rend të ditës. Tani, a jeni që të miratohet rendi i ditës komplet? Pra, me të gjitha votat pro miratohet edhe rendi i ditës.

Si pikë e parë e rendit të ditës:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e gjashtë e kuvendit komunal

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Hapi debat për këtë pikë. Pasi që nuk ka për debat e qes në votim. Pra, me të gjitha votat pro, pa asnjë votë kundër, asnjë abstenim miratohet procesverbali.

Si pikë e dytë e rendit të ditës:

2. Pasqyrat financiare të buxhetit komunal për periudhën janar-qershor 2025

znj.Milihate Ajeti, drejtoresha e financave: Përhëndetje për të gjithë të pranishmit! Buxheti i aprovuar për vitin 2025 në total për të gjitha kategoritë ekonomike është 18 milion e 482 mijë 823.87 euro. Buxheti i alokuar

për periudhën janar-qershor 2025, për të gjitha kategoritë ekonomike është 11 milion e 658 mijë e 317.12 euro, ndërsa për 3-mujorin e dytë, për të gjitha kategoritë ekonomike është 10 milion e 795 mijë e 417.62 euro. Shpenzimet për kategorinë paga dhe shtesa është shpenzu 95.05%. Shpenzime në kategorinë janë shpenzu 90.63%, shpenzimet komunale janë 85.25%, shpenzimet për subvencione 51.49% dhe investime kapitale 94.27%. Te pasqyrat financiare e keni të prezantuar edhe buxhetin e aprovuar, të alokuar dhe shpenzuar për të gjitha programet buxhetore: Zyra e Kryetarit 75.99%, Administrata dhe Personeli 91.55%, Inspeksioni 94.36%, Zyra e Kuvendit 95.96%, Buxhet e Financa 94.28%, Shërbimet Publike 90.15%, Zyra e Komuniteteve 92.70%, Bujqësia, Pyltari, Zhvillim 54.69%, Gjeodezia, Kadaster 89.38%, Planifikimi Urban dhe Mjedesi ka shpenzuar 98.58%, Shëndetësia 99.00%, Shërbimet Sociale 94.66%, Kulturë, Rini dhe Sport kanë shpenzuar 97.16%, Arsim dhe Shkencë 92.91%, Të hyrat buxhetore komunal vetanake të planifikuara dhe të realizuara për periudhën janar qershor të vitin 2025, të hyrat e planifikuarara për vitin 2025 janë 1 milion e 270 mijë e 127 euro, të hyrat e planifikuar për periudhën janar-qershor 2025 janë 635 mijë e 63.50 euro dhe të hyrat e realizuar për periudhën janar-qershor 686 mijë e 846.21 euro, apo shprehur në përqindje realizimi, duke u bazuar në planifikimin 6-mujor është 108.15%, ndërsa duke u bazuar në planifikimin vjetor është 54.08%. Krahasimi i të hyrave vetanake për periudhën janar-qershor 2025 dhe të hyrat e periudhën janar-qershor 2024, 480 mijë e 306.73%. D.m.th, të hyrat për vitin 2025 janë më të larta për 206 mijë e 539.48 euro. Prezantimi analitik i investimeve kapitale për periudhën janar-qershor 2025. Gjatë kësaj periudhe shpenzimet nga investimet kapitale janë 3 milion e 357 mijë e 207 euro, që i keni të paraqitur në mënyrë të detajuar në raportin që keni marrë, materialin. Vlen të theksohet se, nga shuma totale 1 milion e 970 mijë e 523.34 euro janë të ekzekutara nga Komuna e Vitisë për projekte që kanë punë të kryera në teren, dhe me situata të pranuar nga organi mbikëqyrës, ndërsa shuma prej 1 milion e 386 mijë e 683 euro janë shpenzimet e ekzekutuara nga thesari i shtetit, e që këto shpenzime janë obligime të viteve të mëhershme, që rrjedhin nga kontrata kolektive. Dhe në fund e keni të prezantuar krahasimin e shpenzimeve për periudhën janar-qershor 2025, me të njëjtën periudhë të vitit 2024, shpenzimet e vitit 2025 në krahim me shpenzimet e vitit 2024 janë më të ulta për 866 mijë e 406 euro. Kjo ishte në pika të shkurta. Për çdo pakjartësi ose pyetje shtesë jam në dispozicionin tuaj.

z.Jakup Demiri: Unë do të ndalem vetëm te 3 kode, te kodi 13440 shërbime këshilldhënëse dhe profesionale velra 283 mijë e 11 euro, kodi 13445, shërbimet e veçanta kontraktuara dhe konsulent, konsulent individual prapë i kemi 5317 euro, kodi 13460 shërbime kontraktuse tjera 33 mijë e 578 euro, e që në total i bjen 321 mijë e 906 euro, ndërsa me krahasimin e vitit të kaluar i kemi të shërbimet këshilldhënëse dhe profesionale, vitin e kaluar i kemi pas 65 mijë e 427 euro, ndërsa këtë vit i kemi 283 mijë euro.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës: Shërbime të ndryshme intelektuale dhe këshilldhënëse, marrëveshja me AZHR-në për realizimin e aktiviteteve në fushën ekonomike lokale, 17 mijë e 850 euro, shërbime të ndryshme intelektuale dhe këshilldhënëse, marrëveshje me UNDP-në, 40 mijë, shërbime të ndryshme intelektuale këshilldhënëse dhe përmirësimi i shërbimeve në sektorin e arsimit, shëndetësisë dhe administratës, 298 mijë, shërbime të ndryshme intelektuale dhe këshilldhënëse, marrëveshje me Crosborderin, 5 mijë, shërbime të ndryshme intelektuale dhe këshilldhënëse, hartimi i hartave zonale 89 mijë e 289 euro, shërbime të ndryshme intelektuale dhe këshilldhënëse, marrëveshja me Kosova Med 101 mijë.

z.Jakup Demiri: E kemi kërku me na ardh të specifikume, te krenjt këto shpenzime, personat të cilët janë këshilltar, këtu kush merr rrogë, kush merr pare, e kjo mu nuk me pëlqen, se janë persona të caktum që i njohim. Te puna e hartave zonale, shumë kemi pas fol. Jemi perla e konfrontu për UBT-në, e që në fund edhe ligji e ka gjetë që është ndesh me ligjin. Unë nuk e di se çfarë konsulent dhe çfarë këshilltar janë, nuk e di çfarë roli kanë, ama për që nuk bajnë kurgja hiç ju betohem në Zot. Vitin e kaluar kam bërë pyetje këtu, a e keni një marrëveshje me një kompani të huaj 3,1 milion euro. Jo thojshi, e tani po del që është ajo marrëveshje e cila përfundon në fund të 2025, e kur ta kqyrsh ne sa buxhet kemi, ka me na shti në rrugë pa krye kjo marrveshje, se nuk kemi kapacitete buxhetore për me mbulu atë marrëveshje me këtë afat.

znj.Majlinda Shabanli: Në mbledhjen e KPF-së e kemi kërku disa sqarime për disa kode të veçanta buxhetore, për të cialt sqarime nuk na kanë ardh. Tash po arsyetohen që kan harru me na e shpërnda. Nuk po

konisdroj që është një dokument që duhet me u harru me u shpërmda. Ajo çka na intereson neve me diskutu këtu tek pasqyrat financiare, arsyetimin që po e jep nënkryetari, kritikën e kam pas te mbledhja e komitetit për shërbime këshilldhënëse dhe profesionale, ku nuk e dimë se ku janë tu shku ato shërbime, dhe cili është rezultati i atyre shërbimeve. Vetëm sa i numrove ti. Me i mbledh të gjitha po e tejkalojnë shumën 1 milion. Tash me llogarit që 1 milion jepen për shërbime këshilldhënëse dhe profesionale, dhe në fund nuk e di se ku është rezultati i atyre shërbimeve, qëky është një keqpërdorim i parasë publike. Nuk kemi rezultat. Unë nuk e di ku janë tu nejt ata persona të cilët janë për këtë punë me kry. Nëse dalim me i pa investimet që janë duke u bërë në aspekt ekonomik, në cilin do aspekt të Komunës së Vitisë, tu e ndërlihd dhe te prezantimi analitik i investimeve kapitale, na jemi tu e pa që, projektet të cilat po nisen po përfundojnë në Komunë të Vitisë. Paraja shpenzohet, punimi nuk bëhet si duhet. Te mirëmbajta e rrugëve lokale. Është një shumë begi e konsiderueshme, dikun 167 mijë që janë të pasqyrume te pasqyrat financiare, dhe nëse dalim me pa gjendjen në teren. Çka na intereson neve se sa janë tu shpenzu qato pare për me u mirëmbajt ato rrugë lokale, dhe çka hynë në ato rrugë lokale. Tek mirëmbajta e ndërtesave afariste, prapë e kemi të njëjtin shpenzim, që është shpenzim i madh. Çka konsideron mirëmbajtje e ndërtesave afariste. Dhe tjetra është te prezantimi analitik i investimeve kapitale për periudhën janar qershor. Pikërisht ky prezantim është njëra prej demantimeve, që kohet e fundit e kemi parë. Nënkryetar, e din që Sokol Haliti ka dal e ka prezantu rrugën e njakut si investim që është bërë nga komuna, e nëse ish bërë nga komuna, ish dashtë me u prezantu te pasqyrat financiare si shpenzim që është bërë, mirëpo nuk është e prezantume askund, andaj ky është një manipulim i opinionit publik, që vazhdimisht është tu bërë. Kemi pas kritika të vazhdueshme për sa i përket mungesës së informacioneve në asfaltim të rrugëve që bëhen, sepse problemi më i amdë në komunë tonë është që, rrugën që duhet me u asfaltu nuk planifikohen paraprakisht për vitin që duhet me u përfundu, dhe prandaj kemi rrugë që ndoshta për 5-6 vite presin me u asfaltu, dhe në fund e shef që një rrugë brenda 1 viti, mos të themë 10 ditë ose 2 javë para zgjedhjeve hinë në procedurë edhe çështjet e tenderit me u hapë, me u shtrur ai asfalt. Te çështja tjetër, në shesh është cek ndërtimi i sheshit. Nuk është cek cila fazë është. Edhe nënkryetar, unë kam qenë shumë kritikues sa i përket ndërtimit të sheshit që është bërë. Kam pas diskutime dhe me qytetarë të Komunës së Vitisë. E para, nuk e di se kërkesë e kujt ka qenë, se ideja kur të bëhet një investim në Komunë të Vitisë, a duhet me u bazu kryetari ose ju si ekzekutiv në diçka që është kërku ai investim me u bërë. Sheshi që është ndërtu në Komunën e Vitisë, është shesh që e para e ka blloku qarkullimin në komplet qytetin e Vitisë. Sheshi është shumë i madh, dhe nëse e shef është komplet i betonizum sheshi i Komunës së Vitisë, nuk ke asnjë gjelbrim në sheshin e ri që është ndërtu në pjesën andej te pjesa te komuna, nuk keni parapa asnjë hapësirë, të paktën që kishte me qenë ndonjë hapësirë gjelbruse. E patem një qytetarë që hyri në seancë të kuvendit komunal, dhe pati me të drejtë kritikën, ku tha që te parku që është në qytet nuk është bërë asnjë investim, të paktën qata me rregullu me bërë si këndë për fëmijë, me pas lodra. Unë konsideroj që aty nuk kishin shku më shumë se 10 mijë euro për ata fëmijë të cilët dalin në shesh. Në park me investu aty. Disa drunj i keni mbjell, i keni hekë. Nëse e shef në anën tjetër i ke 30 hapësira gjelbruese që janë premtu dhe nuk ke askund.

z.Taulant Haxhiu: Shërbimet këshilldhënëse dhe profesionale 283 mijë euro. Nuk e ceke kur i ndajte. Te Zyra e Kryetarit, te kodi 16033, shërbime këshilldhënëse dhe profesionale, veç te Zyra e Kryetarit i kemi 40 mijë, shërbime kontraktuse kemi 33 mijë të gjitha. Te Zyra e Kryetarit i kemi shërbime kontraktuese 27 mijë e 940 euro. Furnizime për zyre 5 mijë e 142 euro, 950 muajt furzime për zyre. Këtë nuk po e kuptoj çka është këtu. Telefonia fikse 3579, 596 euro në muaj. Çka hargjon telefoni fikse. Telefoni mobile 4163, që i bjen në muaj 1910 euro shpenzojm telefoni mobilje.

z.Nexhat Halili: Sa i përket tek të hyrat vetanake, në bazë të raportit që është paraqit, unë i përgëzoj në realizim të këtyre të hyrave, por sa i përket përqindjes tek të hyrat tjera, atëherë ju i keni inkorporu inkasimi që bëhet, por nuk e keni inkorporu planifikimin. Te krahasimi i shpenzimeve nga viti 2025, të njëjtin periudh të vitit 2024, tatimi në të ardhura personale, kodi 1121, 61515 euro, 48 e ke diferencën mes 2024 dhe 2025. A është llogarit në rregull, kur pagat neto në 2025 i ke më të mëdha se në 2024. E tash tatimi në të ardhura perosnale del më i madh në 2024 se në 2025. Merme analizone këtë pikë. Te pika energjia elektrike, vitin e kalum ka qenë 77.519.80, ke minus 4824. Çka është problemi te energjia elektrike, ku është rrit çmimi? Drejtoreshë, te faqja

28, shpenzime paga dhe medetje për vitin 2025 janë më të ulta për 1 milion e 770 088.13 në krahasim me vitin 2024. Çka ka ndiku, pse ka ardhë paga me qenë më të ulta këtë vit se vitin e kaluar? Kodi 13509, pajisje tjera: a përfshihet dhe Crosborderi këtu, dhe a mund të na shpjegoni, i keni 3 kontrata, a me persona fizik? Njërin e keni 500 euro, që për 2 vite bëjnë 12 mijë euro, njërin e keni me 1200 për muaj, 28 mijë euro, plus një tjetër 500, që bëjnë mbi 50 mijë euro. Si këshilldhënës, në bazë të çkahit janë këto kontrata. Te investimet kapitale, te rruga e Mjakut, nuk paraqitet nëse është investim që e ka bërë komuna. Këtu duhet me qenë shpenzimet. Ju i keni mbi 30 mijë euro obligime që janë të deklaruar në fund të vitit 2024, vlera është 32 mijë e 862.60 euro që i keni obligime ndaj operatorit ekonomik të parit, se kontrata e parë ka qenë mbi 400 mijë euro. Ajo është ndërpre, keni obligime. Sa janë shpenzime për operatorin e parë, sa janë për të dytin? Të dytin e keni mbi 700 mijë euro shuma e përgjithshme, që e ka ndal ministria, janë mbi 800 mijë euro për këtë projekt. Ndërtimi i palestrave sportive. Operatori ekonomik "Euro Komerc, 96 mijë euro. Cili është obligimi, cili është realizu më shumë? Se gjithmonë shkon shkolla "Kuvendi i Lezhës", shkolla Sllatines, dëshmorit "Njazi Rexhepi", i bëni bashkë. Pse? Sa janë kry punë deri tash te shkolla e dëshmorit "Njazi Rexhepi" dhe sa te "Kuvendi i Lezhës", sa janë bërë pagesa? Renovimi i ambulantave, 10 mijë euro. Drejtoreshë, banjot janë pa rregullu. 2 banjo nuk jeni në gjendje me i rregullu. Mjetet i keni, kontratën e keni: si është e mundur? Drejtor i inspeksionit, te shenjat e komunikacionit, kontrata është lidh në 2021, mbi 40 mijë euro. Pagesa ju është bërë në 2025. 7 mijë janë bërë në 2024, ndërsa pjesa tjetër 2025. Ajo tash ka përfunduar, keni kontratën tjetër 100 mijë euro, që nuk shihet kund, asnjë pagesë. A është vendos ndonjë shenjë e komunikacionit? Ajo kontratë është lidh në vitin 2024, ka përfunduar në vitin 2025. Tash fillojnë procedurat e prokurimit, kontratën tjetër, ku kjo kontratë 0. Si është e mundur?

z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës: Majlinda, a është investim i komunës apo i qeverisë, askush nuk e ka kontestu që parat i ka dhënë qeveria, por projektin e ka nxjerr komuna, as nuk e ka ditë qeveria ku është Majku, as nuk është kjo qeveri, kjo ka fillu shumë më herët. Ju i dini paraqitjet e mia në 2014 nëpër televizione, që është apeli, që është një fshat i braktisur, kemi arrit me nxjerr si projekt që ka dhe nënprojekte tjera, që e kanë vazhdu këta të juajet pjesën tjetër në ekzekutimin e mjeteve, prandaj është projekt të cilin procedurat e prokurimit i ka udhëheq Komuna e Vitisë. Vita nuk është kopil i Kosovës, është fëmij i Kosovës sikur komunat tjera. Këtë duhesh me pas të kuart. Ti herë thu nuk po bashkëpunoni, herë pse nuk po e ndani meritën e kësaj. Merit është e jona që e kemi ngrit si problematikë, edhe nuk është merit e kësaj qeverie, se ka qenë memorandum. Shumë po lëndohesh për merita, ti veq bërë një projekt. Nexhat, po më vjen shumë keq që po i bisedoni disa çështje krahasimore, që po thu pse vjet qekaq e sivjet kaq. Ti e din, je ekonomist, mund të ndodhë vitin e kaluar ke pagu faktura më shumë këtë vit, ke obligime, dalin 9-mujor, tani më shumë edhe ato ndodhin. Ti je ekonomist, këto çështje nuk i baj dhe ti po ndalesh në çdo detaj, pse kjo, ashtu që vet e din këtë punë mirë, se në rast se nuk e ke ditë, duhesh me mësu. Taulant, kanë mbet disa telefona. Unë nuk kam që i vënë drejtpërdrejt m'i lidhë.

z.Basri Aliu, drejtor i shërbimeve publike: Për telefona që i kemi nëpër zyre, përveç telefonave, është çështje e internetit, që është prej postes, ato shkojnë komplet me numër dhe internet. Ne kemi mendu që me i largu disa, po çështja e internetit, aty ku vijnë nuk kemi mujtë me i largu.

z.Nexhat Halili: Prezantimi analitik për periudhën janar-qershor 2025. A mundeni këtë listë veç një me tregu. Cili projekt është i këtij viti, projekt i ri, se nuk po e shof asnjë. Të gjitha janë obligime të vitit kaluar, që janë bartë këtë vit.

z.Taulant Haxhiu: Veç ta di, kjo rruga që është shtruar Vernez Vernakoll, qaj investim me çfarë strategjie është bërë ai investim aty ku është i boshatisur komplet.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës: E jona ka qenë që me shtruar rrugën alternative të Letnicës dhe Ipeshkvi e kaqperdor autoritetin e vetë. Në respekt të kryetarit ka thënë jo veç këtë, por shtinë projekte sa më shumë, por projektet të cilat e prekin, e frekuentojnë atë pjesë. Aty ka disa varreza, është ambasada kroate, është kisha dhe krejt ato, se nuk e kishi parë atë nuk ka pas me dhanë hiç ministri, por e ka bërë ndikimin dikush tjetër që Rshati ka qenë takim me mua kur ka qenë ipeshkvi. Mirë u bë, se ka thënë këtë pjesë, po du me investu dhe ajo pjesë është pjesë e Vitisë.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Faleminderit për kontributin!

Si pikë e tretë e rendit të ditës:

3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen në diskutim publik projekt planin e punës së Kuvendit Komunal të Vitisë për vitin 2026

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Planin e punës e kemi. Çka e kemi të miratim vitin e kalum ju kisha kërku që i njëjti plan i vitit të kalum të del në diskutim publik, që në diskutim publik nëse del diçka të plotësohet, që të miratohet një plan për kuvendin e ardhshëm që do të jetë në vitin e ardhshëm. Është në aspektin ligjor i përmbajtur. Hapi debat, pasi që nuk ka, a jeni që të miratohet. Pra, me të gjitha votat pro, pa asnjë votë kundër, asnjë abstenim miratohet edhe kjo pikë. Me pëlqimin e juaj kisha kërku që ta shtimë në rend të ditës para që t'i lirojmë, që kanë me shku në diskutim publik.

Si pikë e katër e rendit të ditës:

4. Propozim vendim për bartjen e të hyrave vetanake nga një proejkt në projektin tjetër

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Drejtoreshë, nëse ke diçka me shtu, se në fillim e cekum se janë mjete të DEMOS-it që kanë me u dhanë.

z.Jakup Demiri: Propozim vendim për bartjen e të hyrave vetanake nga një proejkt në projekt tjetër. Shembull me këtë propozim vendim kryetari i komunës propozon bartjen e të hyrave vetanake nga një projekt në tjetër. Asfaltimi i rrugës Sllatinë Viti, shuma 10 mijë euro, pse rruga Sllatinës.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: U takova me Islamin, tha që këto janë mjete që për këto projekte janë të mbarume. Nuk ka me u dhanë asnjë cent më, dhe këto mjete nëse mbesin kanë me u bartë që nuk mund të realizohen këtë vit, dhe këto mjete i kanë mbledh, ku kanë mbetë nëpër projekte.

z.Jakup Demiri: Pse nuk realizohen projektet, pse mos me i bartë ne për mos punën e komunës, pse keni hy borxhev, pse nuk i keni planifiku siç duhet.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës: Ka qenë që mund të thojmë një gabim teknik, se grand i performances merret edhe prej DEMOS-it, edhe ka parë të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe këta kur e kanë bërë egzekutimin i kanë marrë projektin të administrimit pushtetit lokal edhe i kanë egzekutuar të këtyre demosit parat janë egzekutuar por janë egzekutuar me një kodë tjetër.

z.Nexhat Halili: Po shihet profesionalizmi i atyre 2 profesionalistave të komunës. Asfaltimi i rrugës Sllatinë po deklarohet që ka përfunduar ndërtimi i urave, "Jezava" "Gelbushi", Podgorc, Budrikë, Skifteraj, ky as që ka fillu. Tash ju parat po ja merrni, çka bëni me këtë projekt, ku i gjeni. Ndërtimi i palestarve sportive Sllatinë, te "Kuvendi i Lezhës", e dini sa keni bërë pagesa, veç 40 mijë euro. Te Sllatina e Epërme keni bërë mbi 100 mijë. Ato projekte janë në fazën gati se fillestare, ju parat po ua merrni: çka bëni me ato projekte? Ndërtimi i parkut të qytetit a ka përfunduar, dhe ky është me grand të performances.

z.Taulant Haxhiu: Ndërtimi i parkut të qytetit Viti. Ku është ky park?

z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës: Është të shkolla "Dëshmorët e Vitisë, është projekt i gatshëm, sipërfaqja 1 hektar e 70 ari.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Nuk bartet prej shërbime në kapitale, për shkak se DEMOS-i ka pas begi disa investime në Viti. Ka qenë investim i madhë i grandeve për një kohë të gjatë, dhe është obligim i DEMOS-it që nuk duhet me hy ne përmes gjykatave, që kjo shumë rritet. Është marrëveshje, që ma mirë ta kalojmë këtu se sa dyfishohet. Kisha kërku që të miratohet. E qes në votim. Kush është për? 12 pro, 2 kunder, 4 abstenime, kalon dhe kjo pikë.

Si pikë e pestë e rendit të ditës:

5. Informatë nga DKA-ja, përfundimi i vitit shkollor 2024/2025

znj.Arta Ajeti, drejtoreshë e DKA-së: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Mësimi për vitin shkollor 2024-2025 ka përfunduar në të gjitha shkollat me datat e parpara nga kalendari i MASHT-it, sipas udhëzimit administrativ që kemi 04-2024. Përfundimi i vitit sipas niveleve shkollore. I kemi klasat parafillore dhe klasat 1-8, ku përfunduan mësimin me 23.06.2025. klasat e 9, 10, 11 përfunduan mësimin me 05.06.2025. Klasat e 12-

ta përfunduan me 15.05.2025. Këtu kanë pas hapësirë që të përgatiten edhe për testin e maturës. Nxënësit e klasave 1-5 përfunduan vitin me notë mesatare 4.23, duke reflektuar një nivel të mirë të arritshmëris, nxënësit e klasave 6-9 përfunduan vitin me notë mesatare 3.41, klasat e 9, 10, 11 përfunduan mësimin me 05/06/2025. Nxënësit e klasave 10-12 përfunduan mësimin me notë mesatare 2.88, Testi i maturës në Komunën e Vitisë për vitin 2024-2025 është mbajtur me 23 qershor 2025, ku u paraqiten 295 nxënës maturant. Nga ata, 201 nxënës kaluan testin, ndërsa 94 jo, por e kanë edhe një test në fund të gushtit. Testi arritshmërisë është mbajtur me 27.06.2025 për vitin shkollor 2024-2025, ku në këtë test morren pjesë 520 nxënës të klasave të 9-ta, me mesataren aritmetike të pikëve 46.5. testi ndërkombëtar pisa është mbajtur për herë të tretë në shkollë tona duke përfshirë në disa shkollë të përzgjedhura si pjesë e kampionit të testimit poashtu kemi regjistrimet dhe konkruset në përputhje me udhëzimin e mashtit janë hapur të gjitha konkurset për regjistrimin e fëmijëve që të mos ju marrë kohë më shumë materialin e keni marrë me kohë për qdo pyetje shesë janë në dispozicionin tuaj.

z.Musli Neziri: Drejtoreshë, e morra përgjigjen me shkrim për kërkesën që kemi pas nga këshilli i prindërve. Të falenderoj për bashkëpunimin. Unë këtu përgjigjet e tua do t'i diskutoj me këshillat e prindërve. Më ineteron te testi PISA, që është mbajtur këtë vit. Unë të kam kërku dhe personalisht, që kushte nuk ka pas, me u mbajtur. P.sh.: testi pisa u mbajtur në shkollën ku jam, dhe unë mësimdhënës dhe ka pas vështirësi më së pari me sigurimin e laptopave. Ka qenë stresuese për nxënësit të cilët ju kanë nënshtruar testit PISA dhe çfarë rezultati jep ai. Unë çka kërkoj këtu, që si drejtori që kur ti keni takimet në ministri, ne jemi për me mbajtur testin. Përdoret testi PISA në arsim me të bë shantazh, sepse ju nuk keni dhënë rezultat, se kështu ju ka dal dhe jeni të dobët. Ne jemi për me ju nënshtruar testit, por sigurona kushtet, të ketë laptop, sepse nuk ka pas kushte me u mbajtur, ose të krijohen kushtet ose mos të mbahet. Të zgjidhet kjo punë. A e din shifrën se sa nxënës janë regjistruar në klasë të 10-të në Komunë të Vitisë? Sepse e dimë që sa kanë qenë klasë të 9-ta dhe sa bëhen në klasë të 10-ta, sepse po na ikin nëpër qytete tjera. Dhe tek bursat, aty në vendim u thënë: kush ka apliku ka marrë bursë. A ka pas kritere? Sepse ne e dimë që vitin e kalim janë refuzu, se ka pas bursë të universitetit, nuk ka marrë bursë të komunës, edhe pse unë kam qenë që ai nëse ka bursë të universitetit me marrë edhe të komunës, sepse ai është një kaliber tjetër me kualitet. D.m.th, a ka pas kritere? Se të gjithë kanë apliku dhe kanë marrë. Dhe te renovimi i shkollave. Kemi pas kërkesa prej prindërve: a kanë fillu renovimet nëpër shkollë që i kanë cek drejtorët, apo mos të ndodh që në shtator na vijnë renovimet.

z.Jakup Demiri: Drejtoreshë, raporti më duket i vogël, po ja nisi prej fundit. Tani jemi në fazën e renovimit, riparimit të objekteve shkollore, duke u përgatitur për një fillim të mbarë të vitit shkollor. U kanë mirë me i cek, cilat shkollë janë dhe në këto cilat shkollë kanë ujë të pijshëm, se me gjasë asnjë shkollë nuk ka ujë të pijshëm. Unë para 2-3 muaj kam fol për 5 shkollë që pikin, dhe 2 objekte që pikin. Njëri është ky dhe komuna e re. Sa është numri që pikin? Tjetra, bursa. Këtu shkruan për vitin akademik 2024-2025. Viti akademik 2024-2025 ka përfunduar. Kujt i duhen më këto bursa, pse vonohen? Nota mesatare këtë vit më duket reale, vitet tjera ndryshon shumë. Kur t'i shikojsh statistikën e notave mesatare me vitet tjera, duket me qenë si skandal. Pse me ra kaq shumë? Por mendoj që ky raport është më real. Do të ishte mirë me qenë, se sa ka pas mungesa.

z.Illir Zuka: Mua më është dokë nota mesatare pak shqetësuese prej 10-12, që është 2.88; dhe a keni ndonjë numër të caktuar, a rrezikohen shumë shkollë për mungesë të nxënësve? D.m.th, për fshatra që janë më të vogla. Dhe në Pozheran shkollë ka nevojë për një intervenim të vogël për ngjyrosje.

znj.Arta Ajeti, drejtoreshë e DKA-së: I nderuari Musli Neziri, për testin pisa pajtohem plotësisht, edhe pse dita që ju kanë nënshtruar nxënësit tanë ka qenë një ditë shumë e ngarkuar, sidomos për juve mësimdhënësve të caktuar aty, edhe pse kemi pas mungesë të laptopave. Jam mundu që nëpër shkollë përmes drejtorëve, kolegeve tanë ti grumbullojmë laptopat, fëmijët të mos i lajm keq atë ditë. Kam kërku vitin e kalim dhe këtë vit. Për momentin nuk kam përgjigje, edhe pse dihet që është kjo sfidë për këtë vit, për shkak përmbaruesit, që të furnizohen me kompjuter, por shohim vitin tjetër, por është mirë që edhe minsitira, por edhe komuna, që të paktën një shkollë ta furnizoj me kompjuter. Për regjistrimin e klaseve të 10-ta nuk mund të jap një numër të sakt, për arsye se, edhe në gusht kemi një afat regjistrimi të dytë, ku shpresojmë do të na vijnë nxënësit që nuk kanë mujtë të regjistrohen. Për bursat nuk është cek për të gjithë studentët, por për të gjithë studentët që kanë

plotësuar kriteret. Ka pasur kriteret të ndryshme. Këto janë të rregullme me rregullore. Rregullimet nëpër shkollë kemi filluar, edhe pse me një buxhet mjaft të ngushtuar kemi intervenu te shkollë "Dëshmorët e Vitisë", ku siç e dimi kemi pasë shkollën e mesme në renovim. Tash veç ju ka bërë pranimi teknik dhe në shtator do të jenë nxënësit në atë objekt madhështor. Kemi pas nxënësit e ndam tek "Dëshmorët e Vitisë" dhe shkollë e mesme profesionale teknike, ku kuptohet që të sholla "Dëshmorët e Vitisë" kemi pas pasdite ndërrim, dhe këta nxënësit më të rritur ka pas nevojë të intervenohet aty, është intervenu dhe në Skifteraj në shkollë, dhe do shoh tutje sa kam buxhet për shkak që jemi mangët, për shkak përmbaruesit, do të mundohem aty ku është patjetër dhe e domosdoshme, ku është nevoja. Jakup, ta bëjë dallimin e informatës dhe raportin. Unë kam sjellë vetëm informatë, raporti është më i gjërë, ndërsa informata është vetëm sa për të ju informuar. E kam gati edhe raportin, atje do ti keni edhe mungesat e nxënësit, edhe numrin dhe stafin dhe me emër të shkollë, në mënyrë tabelare do të jenë të raportit. Kjo është vetëm informatë. Për ujin e pijshëm për aty ku është funksional uji i pijshëm në qytet dhe fshatra, edhe në shkollë kemi, ndërsa në ato shkollë ku furnizohen me puse janë të obliguar drejtorët e shkollave, që në "Hidromoravë" të ju jepet klor, por për sa kemi ujë të pijshëm, ashtu nuk e di, ndërsa ato vende ku kemi ujësjellësin, ato furnizohen me ujësjellës. Ilir, që the nota mesatare mjaft shqetësuse. Nuk e themë ashtu, edhe pse kemi koleg, nota mestare nuk është e ulët, edhe pse për arsye kemi shkollën e mesme teknike profesionale, ku mund të themë sinqerisht, shumica e nxënësve aty nuk i vazhdojnë studimet dhe nuk janë të interesuar ta ngritin notën 5, pa keqkuptime, dhe kjo ndikon në rënien e përgjithshme të notes mesatare, por mund të ceku që dhe kemi pas të sterngarkuar shkollat e mesme, ku kuptohet "Kuvendi Lezhës" ka qenë tek teknika në katin e 3-të, mjaft shqetësues ka qenë. Po ashtu edhe mësimdhënësat e "Kuvendit të Lezhës" është dahtë të barten në 2 shkollë, në 2 ndërrime. Mund të themë, edhe kjo ka qenë njëra ndër problematikat. Shpresoj dhe uroj këtë vit shkollor ta fillojnë në objektin e tyre.

z.Musli Neziri: Te pjesa e testit PISA thatë se, do të bëjmë çmos me siguri laptop ose kompjuter. Në vitin e kaluar kanë ardh 15 kompjuter shumë të mirë, por pa lidhje në internet, dhe shumë e thjeshtë është. E kam bërë një pyetje, a e blen dikush kompjuterin sot që nuk lidhet me internet, pa wifi me u lidh me kablla, dhe ata fëmijë që kanë ardh me hy në test, 15 kompjuter nuk kemi mujt me i lidh, veç i kemi kqyr. Tu kisha lut që, në Zyrën e Prokurimit, kushdo që i bënë projektet, kur t'i cekë karakteristikat ne ta pyet ndonjë ekspert. Te notat që i cekë në përgjigje të Ilirit, mendoj që te nota mesatare është e rritur, të jemi real. Unë kam pas vizita, ku kemi drejtor shkollave ku thotë që, suksesin mesatar e kam 4.8. A është e mundur me qenë ky sukses i përgjithshëm i shkollës jo i një klase, mendoj nuk është vetëm suksesi i shkollës profesionale, sepse në shkollë profesionale mendoj që ka ngritje të nivelit që na vijnë nxënësit me suksese, sepse ka nxënës shumë talent, mirëpo nota mesatare është një problem tjetër, që nuk varet prej teje, as prej drejtorit të shkollave, por prej mësimdhënësave. Ndoshta duhet të na shqetësojnë kushtet tjera, jo nota mesatare, sepse mendoj që ajo është bile e ngritur kolegu Ilir.

z.Jakup Demiri; Drejtoreshë, nuk është e rëndësishme a është raport apo informatë, ndërsa po thu që raporti është më i madh se informata. Në aspektin e përgjithshëm nuk e di si e keni, por raporti është info e informatës, d.m.th informata është më e madhe se raporti. D.m.th raporti është vetëm një pjesë e informatës. Po raport a informatë nuk ka rëndësi, po të dhënat, po të flas, është më rëndësi ne me ditë, a ka ujë të pijshëm. Kam familjar në qytet, në shkollë, që duhet me i marrë ujë prej shpisë, e mos të flasim nëpër fshatra që nuk ka hiç. Gjendja e tualetëve është e mjerueshme. Në pikën e arsimit, nxënësve besoj që nuk kemi politikë, as ne as akush, por të ndimojmë dhe ta shtym përpara ta rregullojmë gjendjen, se nuk e kemi mirë, se jemi përgjegjës krejt për këtë punë.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Është informatë që është e parpame në planin i kuvendit. Informata paraqet përfundimin e vitit mësimor. Viti mësimor dhe shkollor dallojnë. Viti shkollor përfundon gjithçka, përmbyll, dhe viti mësimor me të dhënat në përgjigjësi që ka mbaru.

Si pikë e gjashtë e rendit të ditës:

6. Propozim vendim për aprovimin e buxhetit të participuar nga fermer përfitues

z.Naim Pira, drejtori i bujqësisë: Konsideroj që kryesuesi fillimisht e elaburoj çështjen se për çka bëhet fjalë, prandaj nuk do të kisha hi më tepër me elaburu. Kërkoj mirëkuptimin e juaj që të votohet, në mënyrë që operatori i cili i sjell pajisjet të i paguhet faktura komplet, edhe 20% i participimit.

z.Musli Neziri: Drejtor, te multi kultivator dhe freza për multikultivator, këto dya: a u dhënë multikultivatori me frezë apo tash i keni nda? Veç ta dimë dallimin, se vitin e kalum multikultivatori e ka pas edhe frezën.

z.Naim Pira, drejtor i bujqësisë: Vitin e kalum ka qenë e njëjtë, bile edhe kos ka pas. Zyra e Prokurimit ka bërë thirrje në këtë formë, dhe në këtë formë e ka marrë operatori. Unë e kam sjellë ashtu siç ka qenë në Zyre të Prokurimit, dhe këto shkojnë njëra me tjetren.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Pasi që nuk ka për debat, e qes në votim. Pra, me të gjitha votat pro, pa asnjë votë kundër, asnjë abstenim miratohet dhe kjo pikë.

Faleminderit nga të gjithë për kontributin e dhënë në këtë seancë.

Mirëupafshim në seancën e radhës!

Mbledhja përfundoi me punë në ora 13:30 min.

Procesmbajtësi:
Fatlum Demiri

Kryesuesi i Kuvendit Komunal:
Bekim Azizi
